

Në bazë të nenit 158-g pika 1) dhe neni 122 paragrafi (1) pikat 2) dhe 3) të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 188/2013, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 198/2018), dhe (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” me Nr.101/2019 dhe 31/2020) Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve miratoi:

## **RREGULLORE<sup>1</sup>**

**për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve**

### **I. Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1**

(1) Me këtë rregullore përcaktohet forma dhe përmbajtja e raporteve financiare dhe përmbajtje e detajuar e raportit vjetor të shoqërove për sigurim dhe/apo risigurim (në tekstin e mëtejshëm: shoqëri e sigurimeve) për qëllimet e raportimit të Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) dhe shfrytëzues të tjerë, si dhe afate dhe mënyra të raportimit në Agjenci.

(2) Shoqëritë e brokerimit në sigurim dhe shoqëritë për përfaqësim në sigurim gjatë përgatitjes së raporteve financiare dhe raportit vjetor i përdorin formularët e përcaktuar të cilët kanë të bëjnë me shoqëritë tregtare.

---

<sup>1</sup> Teksti i konsoliduar i Rregullores është hartuar në bazë të tekstit të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” Nr. 5/2011), Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 41/2011), Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 64/2011), Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. Nr. Nr. 170/2019) dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtjen e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” Nr. 118/2022). Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi ligjore. Për qëllime ligjore janë të vlefshme vetëm tekstet e lartpërmendura të shpallura në Gazetën Zyrtare.

Tekst i konsoliduar jozyrtar

## **II. Raport vjetor Neni 2**

- (1) Raporti vjetor i shoqërive të sigurimeve përmban:
1. 1. Raporte vjetore financiare dhe
  1. 2. Raport vjetor për punën.
- (2) Raporti vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni detyrimisht duhet të përmbajë informata financiare dhe zbulime të përcaktuara me Ligjin e Mbikëqyrjes të Sigurimeve, Ligjin për shoqëri tregtare, Rregulloren për menaxhimin me kontabilitetin, gjegjësisht Standardet ndërkombëtare për raportim financiar (në tekstin e mëtejshëm:SNRF) të përkthyer dhe të botuara në Republikën e Maqedonisë, dhe dispozitat e kësaj rregullore.
- (3) Raporti vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni detyrimisht duhet të nënshkruhet nga ana e të gjithë anëtarëve të organit drejtues të shoqërisë të sigurimeve.

## **Forma dhe përmbajtja e raporteve financiare Neni 3**

- (1) Raportet vjetore financiare të shoqërive të sigurimeve nga neni 2, paragrafi 1, pika 1.1 të kësaj rregullore përbëhen nga raportet në vijim:
- 1.1. Raport për gjendjen financiare (Bilanci i gjendjes)
  - 1.2. Raport për fitimin gjithëpërfshirës (Bilanci i suksesit)
  - 1.3. Raport për rrjedhat e parave
  - 1.4. Raport për ndryshime në kapital, dhe
  - 1.5. Shënime për raportet financiare
- (2) Raportet tremujore të shoqërive për sigurim përbëhen nga raportet në vijim:
- 2.1 Raport për gjendjen financiare (Bilanc i gjendjes) dhe,
  - 2.2 Raport për fitimin gjithëpërfshirës (Bilanc i suksesit) dhe,
  - 2.3 Bilanci Bruto (gjendja përfundimtare)
- (3) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara t'i përpilojnë raportet financiare të theksuara në pikat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 nga paragrafi 1 dhe pikat 2.1 dhe 2.2 nga paragrafi 2 të këtij neni në përputhje me formën dhe përmbajtjen e të njëjtave e përcaktuar me formularët – Raporte financiare të shoqërive të sigurimeve të cilat janë dhënë në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse e saj.
- (4) Në raportet financiare, në kolonën për vitin e kaluar të punës, shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara të prezantojnë vetëm shuma nga raportet e rishqyrtuara financiare të shoqërisë të sigurimeve për vitin e kaluar të punës.
- (5) Të gjitha shumatat në raportet financiare shënohen në denarë.

## **Shënime për raportet financiare**

### **Neni 4**

(1) Shënimet për raportet financiare nga neni 3 paragrafi 1 pika 1.5 e kësaj rregulloreje përpilohen në përputhje me dispozitat e SNRF në mënyrë që të njëjtat të japin:

1. Informata për bazën e përpilimit të raporteve financiare dhe politika të caktuara kontabiliste të aplikuara dhe metoda të vlerësimit në përputhje me SNK 1;

2. Informata në përputhje me kërkesat e SNRF të cilat nuk janë prezantuar në Raportin për gjendjen financiare (Balanci i gjendjes), Raportin për fitimin gjithëpërfshirës (Balanci i suksesit), Raportin për ndryshime në kapital apo Raportin për rrjedha të parave;

3. Shënimet për raportet financiare të cilat japin të dhëna shtesë të cilat nuk janë prezantuar në vend tjetër në raportet financiare por nevojiten për kuptimin e cilësdo pjesë përbërëse të të njëjtave. Këto të dhëna i përfshijnë më së paku të dhënat e theksuara në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse e saj.

### **Raport vjetor për punën Neni 5**

(1) Raporti vjetor për punën e shoqërive të sigurimeve duhet të përfshijë përshkrim të mjedisit të përgjithshëm ekonomik në të cilin punon shoqëria, politikën e punës së shoqërisë, analiza të veprimtarisë së shoqërisë, rezultatin financiar, gjendjen financiare, përshkrimin e rreziqeve bazë në të cilat ekspozohet shoqëria, kapitali aksionar dhe aksionarët e shoqërisë, zhvillimin e shoqërisë, seli/filiale të shoqërisë, aktivitete të selive/filialeve jashtë vendit, të dhëna bazë për grupin sigurues (nëse shoqëria është pjesë e grupit), udhëheqje korporative, strukturë organizative dhe struktura e mjedisit të punës së shoqërisë.

(2) Gjatë përshkrimit të mjedisit të përgjithshëm ekonomik, shoqëria e sigurimeve duhet t'i theksojë faktorët kryesorë të cilët kanë ndikim direkt apo indirekt mbi veprimtarinë e punës së shoqërisë. Në raste kur shoqëria për sigurim kryen vëllim të dukshëm të aktiviteteve të saja edhe në tregjet e huaja, është e nevojshme të përshkruhen trendët më të rëndësishme ekonomike në këto shtete dhe ndikimi i tyre mbi aktivitetet e shoqërisë.

(3) Në raport me politikën e punës dhe qëllimet e shoqërisë, shoqëria për sigurim duhet t'i sqarojë qëllimet afatgjatë të politikës së saj të punës dhe t'i theksojë aktivitetet e planifikuara për përmbushjen e këtyre qëllimeve në vitet e ardhshme. Në planifikimin e këtyre aktiviteteve duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë masave për menaxhim me rrezikun. Shoqëria e sigurimeve duhet ta sqarojë nivelin deri tek i cili është realizuar parashikimi i vitit financiar.

(4) Lidhur me analizën e punës së shoqërisë, shoqëria e sigurimeve duhet të japë përshkrim të detajuar të punës nëpër klasa të ndara të sigurimit.

(5) Lidhur me rezultatin financiar, shoqëria e sigurimeve duhet t'i zbulojë kategoritë kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë për vitin e punës dhe t'i sqarojë ndryshimet e çdo zëri në mënyrë individuale në krahasim me vitin e kaluar të punës.

(6) Në raport të gjendjes financiare, shoqëria e sigurimeve duhet ta zbulojë strukturën e mjeteve dhe obligimeve në Bilancin e gjendjes nëpër kategori të mjeteve gjegjësisht obligimeve dhe t'i sqarojë ndryshimet e çdo zëri në mënyrë individuale në krahasim me vitin e kaluar të punës.

(7) Në raport të përshkrimit të rreziqeve bazë në të cilat ekspozohet shoqëria, shoqëria e sigurimeve duhet ta sqarojë rrezikun tregtar, kreditor, operativ dhe rrezikun nga jo likuiditeti si dhe eventualisht rreziqe të tjera me të cilat përballet shoqëria nëse të njëjtat janë relevante për vlerësim të mjeteve dhe obligimeve të shoqërisë, gjendjen e saj financiare dhe rezultatin financiar. Në përshkrimin, shoqëria është e detyruar të përfshijë edhe masa dhe

aktivitete për menaxhim me të gjitha rreziqet e lartpërmendura.

(8) Në raport me kapitalin aksionar dhe aksionarët e shoqërisë, shoqëria e sigurimeve duhet t'i zbulojë numrin e plotë të aksioneve të dhëna, emrat e aksionarëve, si dhe numrin e vlerës nominale të aksioneve të poseduara nga ana e aksionarëve.

(9) Raporti duhet të përfshijë përshkrim të zhvillimit të ardhshëm të shoqërisë, aktivitetet e saj në pjesën e hulumtimit dhe zhvillimit, si dhe investimet e bëra.

(10) Raporti për punën e shoqërisë të sigurimeve duhet të përfshijë edhe të dhëna të tjera relevante për punën e saj, siç janë të dhënat për rrjetin afarist të shoqërisë, aktivitete të filialeve të shoqërisë jashtë vendit, investimet e shoqërisë, aktivitetet e shoqërisë të sigurimeve në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit, numri i të punësuarve dhe struktura e tyre kualifikuese, mbështetja e teknologjisë informative dhe të dhëna të tjera të cilat llogariten si të rëndësishme për shkak të prezantimit të besueshëm.

(11) Raporti për punën e shoqërisë të sigurimeve duhet të përfshijë edhe të dhëna për raportet (juridike dhe ekonomike) të shoqërisë me kompaninë e saj amë.

(12) Shoqëria e sigurimeve e cila është shoqëri udhëheqëse në kornizat e grupit sigurues duhet t'i prezantojë të dhënat bazë për grupin sigurues dhe t'i identifikojë grupet e shoqërive të përfshira në raport. Të dhënat për shoqëritë në grupin sigurues duhet të përfshijnë emrin e shoqërisë, llojin e aktivitetit, pjesën e poseduar në shoqëri, pjesë në të drejtat votuese, vlerën nominale të aksioneve në fund të vitit të punës dhe strukturën e udhëheqjes korporatave.

(13) Raporti duhet gjithashtu të përfshijë informata për anëtarët e organit drejtues dhe organit mbikëqyrës të shoqërisë.

(14) Raporti vjetor për punën e shoqërisë së sigurimit duhet të përfshijë edhe:

(a) Status juridik dhe seli të shoqërisë të sigurimeve, data e themelimit dhe përshkrimi i ndryshimeve në rregulloret e brendshme gjatë vitit të punës;

(b) Emrin, adresën dhe datën e emërimit të audituesit të autorizuar;

(c) Listën e klasave të sigurimit për të cilat shoqëria e sigurimeve ka leje së bashku me datën e dhënies së lejes për secilën klasë të sigurimit dhe datën prej kur shoqëria për sigurim ka filluar me punë në secilën klasë të sigurimit;

(ç) Listën e llojeve të kontratave për sigurim të cilat shoqëria e sigurimeve i ka lidhur gjatë vitit të punës, me theksim të emrit komercial të çdo kontrate dhe klasën e saj të sigurimit.

### **III. Mënyra dhe afate të raportimit**

#### **Raporte vjetore financiare dhe Raport vjetor**

##### **Neni 6**

(1) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara që të dorëzojnë në Agjenci raportet financiare vjetore të pa audituara për vitin afarist që është i barabartë me vitin kalendarik, jo më vonë se 15 marsi i vitit aktual për vitin paraparak.

(2) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara që në afat prej tetë ditësh nga dita e miratimit të raportit vjetor nga mbledhja e aksionarëve të dorëzojnë në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve një kopje të raportit vjetor të veprimtarisë”.

(3) Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni shoqëria është e detyruar t'i dorëzojë në Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve në afatet e caktuara nëpërmjet postës elektronike në mënyrë të vërtetuar nga Agjencia.

#### **Raporte tremujore financiare Neni 7**

(1) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara të përgatitin raporte financiare tremujore nga neni 3 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje me gjendje të 31 marsit, 30 qershorit, 30 shtatorit dhe 31 dhjetorit në vitin aktual afarist.

(2) Shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara të dorëzojnë në Agjenci raporte tremujore në afat prej 30 ditësh nga skadimi i ditës së fundit nga periudha përlogaritëse për të cilën përgatiten raportet.

(3) Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni shoqëria është e detyruar t'i dorëzojë në Agjenci në afatet e caktuara në formë elektronike në mënyrën e konfirmuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve.

#### **IV. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

**(Neni 7 i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtje e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive për sigurim dhe/apo risigurim i botuar “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 5/11)**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” ndërsa do të fillojë të aplikohet gjatë përgatitjes së raporteve financiare dhe raportit vjetor të shoqërive për sigurim me gjendje të 31.12.2011.

**(Neni 3 i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtje e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive për sigurim dhe/apo risigurim i botuar “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 41/11)**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” ndërsa do të fillojë të aplikohet nga dita e aplikimit të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e skemave bilancore dhe përmbajtjen e detajuar të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive të sigurimeve dhe/apo risigurime (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 5/2011)

**(Neni 6 i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtje e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive për sigurim dhe/apo risigurim i botuar “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 64/11)**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” ndërsa do të fillojë të aplikohet gjatë përgatitjes së raporteve financiare tremujore me gjendje të 30 shtatorit të vitit 2011.

**(Neni 4 i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtje e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive për sigurim dhe/apo risigurim i botuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 187/2013)**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” ndërsa do të fillojë të aplikohet gjatë përgatitjes së raporteve financiare tremujore me gjendje të 31 marsit të vitit 2014.

**(Neni 3 i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtje e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive për sigurim dhe/apo risigurim i botuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 61/16)**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” ndërsa do të aplikohet nga 1 prilli i viti 2016.

(2) Shoqëritë janë të detyruara ta aplikojnë këtë rregullore me përgatitjen e raporteve tremujore për tremujorin e dytë për vitin 2016.

**(Член 2 од Правилникот за изменување и дополнување на Правилникот за формата и содржината на финансиските извештаи и детална содржина на годишниот извештај за работењето на друштвата за осигурување и/или реосигурување објавен во „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 170/2019)**

(1) Овој правилник влегува во сила и е во примена со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“. (2) По исклучок на став (1) од овој член, друштвата за осигурување кои применуваат сметководствени политики на признавање, последователно мерење и обелоденување за трошоците за стекнување кои се разликуваат од барањата содржани во Прилог 3 Упатство за пополнување на финансиските извештаи од овој правилник се должни да обезбедат идна примена на променети сметководствени политики најдоцна со состојбата на одложените трошоци за стекнување на 1.1.2021 година.

**(Neni 2 i Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe përmbajtje e hollësishme të raportit vjetor për veprimtarinë e shoqërive për sigurim dhe/apo risigurim i botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 170/2019)**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi dhe në zbatim ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”. (2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, shoqëritë e sigurimeve që zbatojnë politika kontabël të njohjes, matjes dhe shpalosjes rrjedhimore të shpenzimeve të blerjes së policave që ndryshojnë nga kërkesat e përfshira në aneksin 3 të udhëzimeve për plotësimin e pasqyrave financiare tek kjo rregullore janë të detyruar të sigurojnë zbatimin e ardhshëm të politikave kontabël të ndryshuara jo më vonë se gjendja apo bilanci i shpenzimeve të shtyra të blerjes së policave më 1.1.2021.

**Член 5 од Правилникот за изменување и дополнување на Правилникот за формата и содржината на финансиските извештаи и детална содржина на годишниот извештај за работењето на друштвата за осигурување и/или реосигурување објавен во „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 118/2022)**

Овој правилник влегува во сила наредниот ден од денот на објавување со “Службен

Текст i konsoliduar jozyrtar

весник на Република Северна Македонија” а ќе започне да се применува при изготвување на тримесечните (квартални) финансиски извештаи со состојба на 30 јуни 2022 година.

**Kryetar i Këshillit të Ekspertëve**  
**Kërste Shajnoski**



## **ANEKSI 1**

### **RAPORTE FINANCIARE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE**

1. Raport për gjendjen financiare (Bilanci i gjendjes)
2. Raport për fitimin gjithëpërfshirës (Bilanci i suksesit)
3. Raport për rrjedha të parave dhe
4. Raport për ndryshime në kapital.

## **ANEKSI 2**

### **SHËNIME PËR RAPORTET FINANCIARE**

## **ANEKSI 3**

### **UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTEVE FINANCIARE SHQYRTIM I KONTOS DHE GRUPEVE TË KONTOS NGA PLANI KONTABËL PËR SHOQËRITË E SIGURIMEVE DHE RISIGURIMEVE NËPËR POZITA TË VEÇANTA NGA RAPORTET FINANCIARE**

ANEKSI 1

RAPORTE FINANCIARE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE

Formular BGJ

Emri i shoqërisë të sigurimeve/risigurimeve

\_\_\_\_\_

NUAS \_\_\_\_\_

RAPORT PËR GJENDJEN FINANCIARE (BILANC I GJENDJES)

më datë \_\_\_\_\_

në denarë

Përshkrim i pozitës	Numër i pozitës	Numër i shënimit	Viti aktual i punës	Viti i kaluar i punës
1	2	3	4	5
<b>AKTIVA</b>				
<b>A. MJETE JOMATERIALE (002+003)</b>	001			
1. Gudvil	002			
2. Mjete të tjera jomateriale	003			
<b>B. INVESTIME (005+013+021+041)</b>	004			
<b>I. TOKË, OBJEKTE NDËRTIMORE DHE MJETE TË TJERA MATERIALE</b>	005			
1. Tokë dhe objekte ndërtimore të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë (007+008)	006			
1.1. Tokë	007			
1.2. Objekte ndërtimore	008			
2. Tokë, objekte ndërtimore dhe mjete të tjera të cilat nuk shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë (010+011+012)	009			
2.1. Tokë	010			
2.2. Objekte ndërtimore	011			
2.3. Mjete të tjera materiale	012			
<b>II. INVESTIME FINANCIARE NË SHOQËRI NË GRUP - FILIALE, SHOQËRI TË BASHKANGJITURA DHE ENTITETE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLUARA (014+015+016+017+018+019+020)</b>	013			

Tekst i konsoliduar jozyrtar

1. Aksione, pjesë dhe instrumente të tjera pronësore në shoqëri në grup – filiale	014			
2. Letra debitore me vlerë të cilat i kanë emituar shoqëri në grup – filiale dhe hua të shoqërive në grup – filiale	015			
3. Aksione, pjesë dhe instrumente të tjera pronësore në shoqëri të bashkangjitura	016			
4. Letra debitore me vlerë të cilat i kanë emituar shoqëri të bashkangjitura dhe hua të shoqërive të bashkangjitura.	017			
5. Investime të tjera financiare në shoqëri në grup – filiale	018			
6. Investime të tjera financiare në shoqëri të bashkangjitura	019			
7. Investime në entitete të përbashkëta të kontrolluara	020			
III. INVESTIME TË TJERA FINANCIARE (022+025+030+035+040)	021			
1. Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim (023+024)	022			
1.1. Letra debitore me vlerë me afat të maturimit deri në një vit	023			
1.2. Letra debitore me vlerë me afat të maturimit mbi një vit	024			
2. Investime financiare në dispozicion për shitje (026+027+028+029)	025			
2.1. Letra debitore me vletë me afat të maturimit deri në një vit	026			
2.2. Letra debitore me vlerë me afat të maturimit mbi një vit	027			
2.3. Aksione, pjesë dhe instrumente të tjera pronësore	028			
2.4. Aksione dhe pjesë në fonde investuese	029			
3. Investime financiare për tregtim (031+032+033+034)	030			
3.1. . Letra debitore me vlerë me afat të maturimit deri në një vit	031			
3.2. . Letra debitore me vletë me afat të maturimit mbi një vit	032			
3.3. Aksione, pjesë dhe instrumente të tjera pronësore	033			
3.4. Aksione dhe pjesë në fonde investuese	034			
4. Depozita, hua dhe plasmanë të tjera (036+037+038+039)	035			
4.1. Depozita të dhëna	036			
4.2. Hua të siguruara me hipotekë	037			
4.3. Hua të tjera	038			
4.4. Plasmane të tjera	039			
IV. DEPOZITA TË SHOQËRIVE PËR RISIGURIM TEK CEDUES, NË BAZË TË KONTRATAVE PËR RISIGURIM	041			
C. PJESË PËR BASHKËSIGURIM DHE RISIGURIM NË PRIMET E SHKRUARA BRUTO (043+044+045+046+047+048 +049)	042			
1. Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonin bruto për primin transferues	043			

Tekst i konsoliduar jozyrtar

2.Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonin matematik	044			
3 Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet bruto për dëme	045			
4. Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet bruto për bonuse dhe rabate	046			
5. Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonin bruto të barazimit	047			
6.Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet e tjera teknike bruto	048			
7. Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet teknike bruto për sigurim të jetës ku siguruesi e merr rrezikun investues	049			
Ç. INVESTIME FINANCIARE TEK TË CILAT SIGURUESI E MERR RREZIKUN INVESTUES (KONTRATA PËR SIGURIM)	050			
D. MJETE TATIMORE TË ANULUARA DHE RRJEDHËSE (052+053)	051			
1. Mjete tatimore të anuluar	052			
2. Mjete tatimore rrjedhëse	053			
DH. KËRKESA (055+059+063+067)	054			
I. KËRKESA NGA PUNËT E DREJTPËRDREJTA TË SIGURIMIT (056+057+058)	055			
1. Kërkesa nga siguruesit	056			
2. Kërkesa nga përfaqësues dhe ndërmjetësues	057			
3.Kërkesa të tjera nga punët e drejtpërdrejta të sigurimit	058			
II. KËRKESA NGA PUNËT E BASHKËSIGURIMIT DHE RISIGURIMIT (060+061+062)	059			
1. Kërkesa në bazë të primit për bashkësigurim dhe risigurim	060			
2. Kërkesa në bazë të pjesëmarrjes në kompensim të dëmeve nga bashkësigurimi dhe risigurimi	061			
3. Kërkesa të tjera nga punët e bashkësigurimit dhe risigurimit	062			
III. KËRKESA TË TJERA (064+065+066)	063			
1.Kërkesa të tjera nga punët e drejtpërdrejta të sigurimit	064			
2. Kërkesa në bazë të investimeve financiare	065			
3. Kërkesa të tjera	066			
IV. KËRKESA NË BAZË TË KAPITALIT TË REGJISTRUAR POR JO TË PAGUAR	067			
E. MJETE TJERA (069+072+077)	068			
I. MJETE MATERIALE TË CILAT SHËRBEJNË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË (PËRVEÇ TOKËS DHE OBJEKTEVE NDËRTIMORE) (070+071)	069			

Tekst i konsoliduar jozyrtar

1. Pajisje	070			
2. Mjete të tjera materiale	071			
II. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË TË TJERA MONETARE (073+074+075+076)	072			
1. Mjete monetare në bankë	073			
2. Mjete monetare në arkë	074			
3. Mjete të ndara monetare për mbulim të provigjonit matematik	075			
4. Mjete të tjera monetare dhe ekuivalente të tjera monetare	076			
III. REZERVA DHE INVENTAR I VOGËI	077			
Ë. KUFIZIME AKTIVE KOHORE (079+080+081)	078			
1. Të ardhura të llogaritura më parë në bazë të interesit dhe qirave	079			
2. Shpenzime të anuluar për blerje të policave	080			
3. Të ardhura të tjera të llogaritura dhe shpenzime të anuluar	081			
F. MJETE JO RRJEDHËSE TË CILAT RUHEN PËR SHITJE DHE PUNË TË NDËRPRERË	082			
G. AKTIVA GJITHSEJ (A+B+C+Ç+D+DH+E+F+G)	083			
GJ. EVIDENCË JASHTË BILANCORE – AKTIVA	084			
PASIVA				
A. KAPITAL DHE PROVIGJONE (086+090+091+095+101-102+103104)	085			
I. KAPITAL I SHKRUAR (087+088+089)	086			
1. Kapital i shkruar nga aksionet e thjeshta	087			
2. Kapital i shkruar nga aksionet prioritare	088			
3. Kapital i shkruar por jo i paguar	089			
II. PRIME PËR AKSIONE TË EMETUARA	090			
III. PROVIGJONI I RIVLERËSIMIT (092+093+094)	091			
1. Mjete materiale	092			
2. Investime financiare	093			
3. Provigjone të tjera të rivlerësimit	094			
IV. PROVIGJONE (096+097+098-099+100)	095			
1. Provigjone ligjore	096			
2. Provigjone statutores	097			
3. Provigjone për aksione personale	098			
4. Aksione të blera personale	099			
5 Provigjone të tjera	100			
V. FITIM NETO JO I SHPËRNDARË	101			
VI. HUMBJE E TRANSFERUAR	102			
VII. FITIM PËR PERIUDHËN AKTUALE PËRLLLOGARITËSE	103			
VIII. HUMBJE PËR PERIUDHËN AKTUALE PËRLLLOGARITËSE	104			
B. OBLIGIME TË NËNRENDITURA	105			
C. PROVIGJONE TEKNIKE BRUTO (107+108+109+110+111+112)	106			
I. Provigjone bruto për prime transferuese	107			
II. Provigjon matematik bruto	108			
III. Provigjone bruto për dëme	109			

Tekst i konsoliduar jozyrtar

IV. Provigjone bruto për bonuse dhe lirime	110			
V. Provigjon bruto i barazimit	111			
VI. Provigjone teknike të tjera bruto	112			
Ç. PROVIGJONE TEKNIKE BRUTO NË RAPORT ME KONTRATAT TEK TË CILAT SIGURUESI E MERR RREZIKUN INVESTUES	113			
D. PROVIGJONE TË TJERA (115+116)	114			
1. Provigjone për të punësuarit	115			
2. Provigjone të tjera	116			
DH. OBLIGIME TATIMORE TË ANULUARA DHE RRJEDHËSE (118+119)	117			
1. Obligime tatimore të anuluar	118			
2. Obligime tatimore rrjedhëse	119			
E. OBLIGIME TË CILAT DALIN NGA DEPOZITAT E SHOQËRIVE PËR RISIGURIM TEK CEDUESIT, NË BAZË TË KONTRATAVE PËR RISIGURIM	120			
Ë. OBLIGIME (122+126+130)	121			
I. OBLIGIME NGA PUNËT E DREJTPËRDREJTA TË SIGURIMIT (123+124+125)	122			
1. Obligimet ndaj siguruesve	123			
2. Obligime ndaj përfaqësuesve dhe ndërmjetësuesve	124			
3. Obligime të tjera nga punët e drejtpërdrejta të sigurimit	125			
II. OBLIGIME NGA PUNËT E RISIGURIMIT DHE BASHKËSIGURIMIT (127+128+129)	126			
1. Obligime në bazë të primit për risigurim dhe bashkësigurim	127			
2. Obligime në bazë të pjesëmarrjes në kompensimin e dëmeve	128			
3. Obligime të tjera nga punët e risigurimit dhe bashkësigurimit	129			
III. OBLIGIME TË TJERA (131+132+133)	130			
1. Obligime të tjera nga punët e drejtpërdrejta të sigurimit	131			
2. Obligime në bazë të investimeve financiare	132			
3. Obligime të tjera	133			
F. PËRKUFIZIME PASIVE KOHORE	134			
G. OBLIGIME JO RRJEDHËSE NË LIDHJE ME MJETET JO RRJEDHËSE TË CILAT RUHEN PËR SHITJE DHE PUNË TË NDËRPRERË	135			
GJ. PASIVA GJITHSEJ A+B+C+Ç+D+DH+E+Ë+F+G	136			
H. EVIDENCË JASHTË BILANCORE – PASIVA	137			

**Data:**

**Përpiloi: (emër dhe mbiemër dhe nënshkrim)**

**Personi përgjegjës: (emër i plotë dhe mbiemër dhe nënshkrim)**

Formular BS

Emri i shoqërisë për sigurim/risigurim

\_\_\_\_\_

Grupi sigurimit \_\_\_\_\_

NUAS \_\_\_\_\_

**RAPORT PËR FITIM GJITHËPËRFSHIRËS (BILANCI I SUKSESIT)**  
për periudhën \_\_\_\_\_ deri më \_\_\_\_\_ viti \_\_\_\_\_

në denarë

POZITA	Numri i pozitës	Numri i shënimit	Shuma	
			Viti aktual i punës	Viti i kaluar i punës
1	2	3	4	5
<b>A. TË ARDHURA NGA VEPRIMTARIA (201+210+223a+224+225)</b>	200			
<b>I. PRIM I FITUAR (TË ARDHURA NETO NGA PRIM (202+203+204-205-206-207+208+209)</b>	201			
1. Prim i shkruar bruto për sigurim	202			
2. Prim i shkruar bruto për bashkësigurim	203			
3. Prim i shkruar bruto për risigurim dhe retrocesion	204			
4. Prim i shkruar bruto i dorëzuar në bashkësigurim	205			
5. Prim i shkruar bruto i dorëzuar në risigurim/retrocesion	206			
6. Ndryshim në provigjonin bruto për prim transferues	207			
7. Ndryshim në provigjonin bruto për prim transferues – pjesë për bashkësigurim	208			
8. Ndryshim në provigjonin bruto për prim të shkruar – pjesë për risigurim	209			
<b>II. TË ARDHURA NGA INVESTIMET (211+212+216+217+218+219+223)</b>	210			
1. Të ardhura nga filialet, shoqëritë e bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara	211			
2. Të ardhura nga investimet në toka dhe objekte ndërtimore (213+214+215)	212			

Tekst i konsoliduar jozyrtar

2.1. Të ardhura nga qiratë	213			
2.2. Të ardhura nga rritja e vlerës së tokës dhe objekteve ndërtimore	214			
2.3. Të ardhura nga shitja e tokës dhe objekteve ndërtimore	215			
3. Të ardhura nga interesi	216			
4. Dallime pozitive të kursit	217			
5.Përshtatshmëri e vlerës (fitime jo të realizuara, rënie në vlerë objektive)	218			
6. Fitime të realizuara nga shitja e pronës financiare – fitim kapital (220+221+222)	219			
6.1. Investime financiare në dispozicion për shitje	220			
6.2. Investime financiare për tregtim (për vlerë objektive)	221			
6.3. Investime të tjera financiare	222			
7. Të ardhura të tjera nga investimet	223			
III. TË ARDHURA NË BAZË TË PROVIZIONEVE NGA RISIGURIMI	223a			
IV. TË ARDHURA TË TJERA SIGURUESE-TEKNIKE, TË ZVOGËLUARA PËR RISIGURIM	224			
V. TË ARDHURA TË TJERA	225			
B. REZULTATE NGA PUNA (227+235+245+248+251+261+271+274+275)	226			
I. DËME TË NDODHURA (SHPENZIME NETO PËR DËME) (228-229-230-231+232-233-234)	227			
1. Dëme të paguara bruto	228			
2. Zvogëlim për të ardhurat nga kërkesat regres të realizuara bruto	229			
3.Dëme të paguara bruto – pjesë për bashkësigurim	230			
4. Dëme të paguara bruto – pjesë për risigurim/retrocesion	231			
5. Ndryshime në provigjonet bruto për dëme	232			
6. Ndryshime në provigjonet bruto për dëme - pjesë për bashkësigurim	233			
7. Ndryshime në provigjonet bruto për dëme – pjesë për risigurim	234			
II. NDRYSHIME NË PROVIGJONET E TJERA TEKNIKE, NETO NGA RISIGURIMI (236+239+242)	235			
1. Ndryshime në provigjonin matematik, neto nga risigurimi (237-238)	236			
1.1. Ndryshime në provigjonin matematik bruto	237			
1.2. Ndryshime në provigjonin matematik bruto – pjesë për bashksigurim/risigurim	238			
2. Ndryshime në provigjonin e barazimit, neto nga risigurimi (240-241)				
2.1. Ndryshime në provigjonin e barazimit, neto nga risigurimi	240			
2.2. Ndryshime në provigjonin e barazimit bruto – pjesë për	241			



Tekst i konsoliduar jozyrtar

bashkësigurim/risigurim				
-------------------------	--	--	--	--

Tekst i konsoliduar jozyrtar

3. Ndryshime në provigjonet e tjera teknike, neto nga				
Risigurimi	242			
(243-244)				
3.1. Ndryshime në provigjonet e tjera teknike bruto	243			
3.2. Ndryshime në provigjonet e tjera teknike bruto – pjesë për bashkësigurim dhe risigurim	244			
III. NDRYSHIME NË PROVIGJONIN MATEMATIK BRUTO PËR SIGURIM TË JETËS KU RREZIKU INVESTUES ËSHTË NË KURRIZ TË SIGURUESIT, NETO NGA RISIGURIMI (246-247)	245			
1. Ndryshime në provigjonin matematik bruto për sigurim të jetës ku rreziku investues është në ngarkesë të siguruesit	246			
2. Ndryshime në provigjonin matematik bruto për sigurim të jetës ku rreziku investues është në ngarkesë të siguruesit – pjesë për bashkësigurim dhe risigurim	247			
IV. SHPENZIME PËR BONUSET DHE LIRIME, NETO NGA RISIGURIMI (249+250)	248			
1. Shpenzime për bonuse (të cilat varen nga rezultati)	249			
2. Shpenzime për rabate (të cilat nuk varen nga rezultati)	250			
V. SHPENZIME NETO PËR ZBATIMIN E SIGURIMIT (252+256)	251			
1. Shpenzime për blerje të policave (253+253a+254+255)	252			
1.1. Provizion	253			
1.2. Bruto paga për të punësuarit në rrjetin e brendshëm shitës	253a			
1.3. Shpenzime të tjera për blerje të policave	254			
1.4. Ndryshim në shpenzimet e anuluar për blerje të policave	255			
2. Shpenzime administrative (257+258+259+260)	256			
2.1. Amortizim i mjeteve materiale të cilat shërbejnë për kryerje të veprimtarisë	257			
2.2. Shpenzime për të punësuarit (258a+258b+258c+258ç+258d)	258			
2.2.1. Paga dhe kompensime	258a			
2.2.2. Shpenzime për tatime të pagave dhe kompensime në pagë	258b			
2.2.3. Kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social	258b			
2.2.4. Shpenzime për sigurim pensional për të punësuarit	258g			
2.2.5. Shpenzime të tjera për të punësuarit	258d			
2.3. Shpenzime për shërbimet e personave fizikë që nuk kryejnë veprim (kontratë për punë, kontratë autoriale dhe raporte të tjera juridike) së bashku me të gjitha shpenzimet	259			

Tekst i konsoliduar jozyrtar

2.4. Shpenzime të tjera administrative (260a+260b+260c)	260			
2.4.1. Shpenzime për shërbime	260a			
2.4.2. Shpenzime materiale	260b			
2.4.3. Shpenzime për rezervim dhe shpenzime të tjera nga puna	260c			
VI. SHPENZIME NGA INVESTIMET (262+263+264+265+266+270)	261			
1. Amortizim dhe përshtatshmëri të mjeteve materiale të cilat nuk shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë	262			
2. Shpenzime për interes	263			
3. Dallime negative të kursit	264			
4. Përshtatshmëri e vlerës (humbje jo të realizuara, rënie në vlerë objektive)	265			
5. Humbje të realizuara nga shitja e pronës financiare – humbje kapitale (267+268+269)	266			
5.1. Investime financiare në dispozicion për shitje	267			
5.2. Investime financiare për tregtim (për vlerë objektive)	268			
5.3. Investime të tjera financiare	269			
6. Shpenzime të tjera nga investimet	270			
VII. SHPENZIME E TJERA SIGURIESE-TEKNIKE, TË ZVOGËLUARA PËR RISIGURIM (272+273)	271			
1. Shpenzime për parandalim	272			
2. Shpenzime të tjera siguroese teknike, të zvogëluara për risigurim	273			
VIII. PËRSHTATSHMËRI E VLERËS NË BAZË TË PRIMIT	274			
IX. SHPENZIME TË TJERA, DUKE PËRFSHIRË EDHE PËRSHTATSHMËRI TË VLERËS	275			
X. FITIM PËR VITIN E PUNËS PARA TATIMIMIT (200-226)	276			
XI. HUMBJE PËR VITIN E PUNËS PARA TATIMIMIT (226-200)	277			
XII. TATIM I FITIMIT, GJEJGËSISHT HUMBjes	278			
XIII. TATIM I ANULUAR	279			
XIV. FITIM PËR VITIN E PUNËS PËR TATIMIM (276- 278-279)	280			
XV. HUMBJE PËR VITIN E PUNËS PAS TATIMIMIT (277-278- 279)	281			

**Data:**

**Përgatiti: (emër, mbiemër dhe nënshkrim)**

**Personi përgjegjës : (emër i plotë, mbiemër dhe nënshkrim)**

Emri i shoqërisë për sigurim/risigurim

\_\_\_\_\_

NUAS \_\_\_\_\_

**RAPORT PËR RRJEDHAT E PARAVE**  
për periudhën nga \_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_ viti \_\_\_\_\_

në denarë

POZITA	Numri i pozitës	Viti aktual i punës	Viti i kaluar i punës
1	2	3	4
<b>A. RRJEDHA TË PARAVE NGA AKTIVITETET E PUNËS</b>			
<b>I. HYRJET E PARAVE NGA AKTIVITETET E PUNËS (301+302+303+304+305)</b>	300		
1. Prim për sigurim dhe bashkësigurim dhe paradhënie të pranuar	301		
2. Prim për risigurim dhe retrocesion	302		
3. Hyrje të parave nga pjesëmarrja në kompensimin e dëmeve	303		
4. Interes i pranuar nga punët e sigurimit	304		
5. Hyrje të tjera të parave nga aktivitetet e punës	305		
<b>II. SHPENZIME MONETARE NGA AKTIVITETET AFARISTE (307+308+309+310+311+312+313+314)</b>	306		
1. Dëme të paguara, shuma të dakorduara të sigurimit, pjesëmarrje në kompensimin e dëmeve nga bashkësigurimi dhe paradhënie të dhëna	307		
2. Dëme të paguara dhe pjesëmarrje në kompensimin e dëmeve nga risigurimi dhe retrocesioni	308		
3. Prim për bashkësigurim, risigurim dhe retrocesion	309		
4. Kompensime dhe shpenzime të tjera personale	310		
5. Shpenzime të tjera për zbatimin e sigurimit	311		
6. Interes i paguar	312		
7. Tatim i fitimit dhe shpenzime të tjera publike	313		
8. Shpenzime të tjera nga aktivitetet e rregullta	314		
<b>III. HYRJET E PARAVE NETO NGA AKTIVITETET E PUNËS (300-306)</b>	315		
<b>IV. DALJETT E PARAVE NETO NGA AKTIVITETET E PUNËS (306-300)</b>	316		
<b>B. RRJEDHE TË PARAVE NGA INVESTIMET</b>			
<b>I. HYRJET E PARAVE NGA INVESTIMET</b>	317		

Tekst i konsoliduar jozyrtar

(318+319+320+321+322+323+324+325)			
1. Hyrjet e parave në bazë të mjeteve jo materiale	318		
2. Hyrjet e parave në bazë të mjeteve materiale	319		
3. Hyrjet e parave në bazë të mjeteve materiale që nuk shërbejnë për kryerje të veprimtarisë së shoqërisë	320		
4. Hyrjet e parave në bazë të investimeve në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara	321		
5. Hyrjet e parave në bazë të investimeve të cilat ruhen deri në maturim	322		
6. Hyrjet e parave në bazë të plasmaneve të mbetura financiare	323		
7. Hyrjet e parave nga dividendat dhe pjesëmarrjet e tjera në fitim	324		
8. Hyrjet e parave nga interesi	325		
II. DALJE TË PARAVE NGA INVESTIMET (327+328+329+330+331+332+333+334)	326		
1. Daljet e parave të mjeteve jo materiale	327		
2. Daljet e parave të mjeteve materiale	328		
3. Daljet e parave në bazë të mjeteve materiale të cilat nuk shërbejnë për kryerje të veprimtarisë së shoqërisë	329		
4. Daljet e parave në bazë të investimeve në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara	330		
5. Daljet e parave në bazë të investimeve që ruhen deri në dorëzim	331		
6. Daljet e parave në bazë të plasmanëve të tjera të mbetura	332		
7. Daljet e parave nga dividendat dhe pjesëmarrjet e tjera në fitim	333		
8. Daljet e parave nga interesi	334		
III. HYRJET E PARAVE NETO NGA INVESTIMET (317-326)	335		
IV. DALJET E PARAVE NETO NGA INVESTIMET (326-317)	336		
C. RRJEDHA TË PARAVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE			
I. HYRJET E PARAVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE (338+339+340)	337		
1. Hyrjet e parave në bazë të rritjes së kapitalit aksionar	338		
2. Hyrjet e parave në bazë të kredive dhe huave të pranuar afatgjate dhe afatshkurte	339		
3. Hyrjet e parave në bazë të obligimeve të tjera afatgjate dhe afatshkurte	340		
II. DALJET E PARAVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE (342+343+344)	341		
1 Daljet e parave në bazë të pagesës së kredive dhe huave afatgjate dhe afatshkurte dhe obligime të tjera	342		

Tekst i konsoliduar jozyrtar

2. Daljet e parave në bazë të blerjes së aksioneve personale	343		
3. Daljet e parave në bazë të pagesës së dividendës	344		
III. HYRJET E PARAVE NETO NGA AKTIVITETET FINANCIARE (337-341)	345		
IV. DALJET E PARAVE NETO NGA AKTIVITETET FINANCIARE (341-337)	346		
Ç. GJITHSEJ TË HYRAT E PARAVE (300+317+337)	347		
D. GJITHSEJ TË DALAT E PARAVE (306+326+341)	348		
DH. HYRJET E PARAVE NETO (347-348)	349		

Tekst i konsoliduar jozyrtar

E. DALJET E PARAVE NETO (348-347)	350		
Ë. PARA DHE EKVIVALENTE TË PARAVE NË FILLIM TË PERIU DHËS PËRLLOGARITËSE	351		
F. EFEKTE NGA NRYSHIMI I KURSIT TË VALUTAVE TË HUAJA MBI PARATË DHE EKVIVALENTET E PARAVE	352		
G. PARA DHE EKVIVALENTE TË PARAVE NË FUND TË PERIU DHËS PËRLLOGARITËSE (349-350+351+352))	353		

**Data:**

**Përpiloi: (emër, mbiemër dhe nënshkrim)**

**Personi përgjegjës : (emër i plotë, mbiemër dhe nënshkrim)**

Tekst i konsoliduar jozyrtar









Tekst i konsoliduar jozyrtar

2.2	Fitime/humbje jo të realizuara nga investimet financiare të disponueshme për shitje												
2.3	Fitime/humbje të realizuara nga investimet financiare të disponueshme për shitje												
2.4	Ndryshime të tjera jo pronësore në kapital												
<b>IX.</b>	<b>Ndryshime pronësore në kapital</b>												
1.	Rritje/ulje e kapitalit aksionar												
2.	Pagesa të tjera nga ana e pronarëve												
3.	Pagesa e dividendës												
4.	Shpërndarja e mbetur e pronarëve												
<b>X.</b>	<b>Gjendja e 31 dhjetorit të vitit aktual të punës</b>												

**Data:**

**Përpiloi: (emri dhe mbiemri i plotë dhe nënshkrim)**

Tekst i konsoliduar jozyrtar

Personi përgjegjës (emri dhe mbiemri i plotë)

## SHTOJCA 2

## SHËNIME NË RAPORTET FINANCIARE

Numri i shënimit	SHËNIME NË RAPORTET FINANCIARE
	<b>Informata të përgjithshme dhe zbulime</b>
1.	Lista me përshkrim të politikave të aplikuara përlogaritëse dhe metodat e vlerësimit, me theks të veçantë në politikat e aplikuara përlogaritëse për investim të mjeteve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik gjegjësisht teknik
2.	Të dhënat të cilat i mbështesin dhe gjithashtu i sqarojnë normat e paraqitura në Raportin për gjendje financiare, Raportin për fitim gjithëpërfshirës, Raporti për rrjedhën e parave, Raporti për ndryshime në kapital – të dhëna shtesë të cilat japin informata më të detajuara për ndryshimet e rëndësishme të pozitive individuale në raportet financiare.
	<b>Informata dhe zbulime në Raportin për gjendje financiare (Balanci i gjendjes)</b>
3.	Pjesëmarrje në investimet afatgjate të shoqërisë të sigurimeve të cilat paraqesin instrumentet e nënrenditura për emetuesin e të njëjtave
4.	Kërkesa nga shoqëritë në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara
5.	Informata dhe të dhëna për obligimet e nënrenditura të shoqërisë për sigurim, dhe atë për çdo detyrim të ri të shoqërisë për sigurim i cili tejkalon 10% nga shuma totale e obligimeve të nënrenditura të shoqërisë për sigurim, me indikacion për shumën e detyrimit, valutën e detyrimit, normën e interesit, kushtet nën të cilat është bërë detyrimi si dhe çfarëdo dispozita të dakorduara për konvertim të borxhit të nënrenditur në kapitalin apo llojin tjetër të obligimit.
6.	Obligime ndaj shoqërive në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara
	<b>Informata dhe zbulime në Bilancin e suksesit (Raporti për fitim gjithëpërfshirës)</b>
7.	Të dhëna për koeficientin e dëmeve, koeficientin e shpenzimeve dhe koeficientin e kombinuar – sipas klasave të sigurimit

## Aneksi 3

### UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTEVE FINANCIARE

#### 1. RAPORT PËR GJENDJEN FINANCIARE (BILANCI I GJENDJES)

##### 1.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në raportin për gjendje financiare (Bilanci i gjendjes) paraqiten mjetet, obligimet dhe kapitali i shoqërive të sigurimeve në ditën e periudhës përlogaritëse gjegjësisht ditën e periudhës së kaluar përlogaritëse.

Gjatë përpilimit të Raportit për gjendjen financiare (Bilanci i gjendjes) në kolonën 4 shënohen të dhëna për vitin aktual ndërsa në kolonën e 5 shënohen të dhëna për vitin e kaluar të punës.

##### 1.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN e pozitave individuale në Raportin për gjendjen financiare (Bilanci i gjendjes)

#### AKTIVA

Pozita nr. 001 me emrin **A – MJETE JO MATERIALE** – paraqet shumën e vlerës së paraqitur në pozitat nr. 002 dhe 003. Kjo pozitë ka të bëjë me mjete në formë jo materiale të cilat shfrytëzohen në veprimtarinë, për të cilat është i vështirë parashikimi i jetëgjatësisë së përdorimit të tyre, transferimi i tyre, si dhe matja e dobisë së ardhshme ekonomike. Format jo materiale të mjeteve janë: emri i mirë, shpenzime për zhvillim, koncesione, patenta, licenca, shenja mbrojtëse, softuer dhe të drejta të tjera të ngjashme. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 00.

Pozita nr. 002 me emrin **A (1) - Gudvil** ka të bëjë me vlerën e gudvil-it të arritur përmes bashkimit afarist i cili në mënyrë kontabiliste trajtohet në përputhje me SNRF 3 – Kombinime afariste. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 000.

Pozita nr. 003 me emrin **A (2) - Mjete të tjera materiale** ka të bëjë me shpenzimet për zhvillim, koncesione, patenta, licenca, shenja mbrojtëse, softuer dhe të drejta të tjera të ngjashme. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 001, 002, 003, 004 dhe 009.

Pozita nr. 004 me emrin **B - INVESTIME** paraqet shumë të vlerës së pozitave nr. 005, 013, 021 dhe 041. Ka të bëjë me të gjitha investimet e shoqërisë të sigurimeve, pavarësisht nga burimet e mjeteve (investimet e mjeteve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik, investime të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike apo investimet nga kapitali). Në këtë pozitë paraqitet edhe vlera e investimeve të shoqërisë në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara.

Pozita nr. 005 me emrin **BI - TOKË, OBJEKTE NDËRTIMORE DHE MJETE TË TJERA MATERIALE** paraqet mbledhje të vlerës së paraqitur në pozitat 006 dhe 009.

Pozita nr. 006 me emrin **B I (1) - Tokë dhe objekte ndërtimore të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë** paraqet shumë të vlerës së pozitive 007 dhe 008 dhe ka të bëjë me tokë dhe objekte ndërtimore të cilat shoqëria për sigurim i shfrytëzon gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj. Trajtimi kontabilist i këtyre mjeteve është në përputhje me SNK 16 – Patundshmëri, ndërtime dhe pajisje.

Në pozitën nr. 007 me emrin **B I (1.1) - Tokë** paraqitet shuma e evidentuar në konton 010, si dhe pjesë e vlerës e paraqitur në kontot 013, 014, 015 dhe 016.

Në pozitën nr. 008 me emrin **B I (1.2) - Objekte ndërtimore** paraqitet shuma e evidentuar në konton 011, si dhe pjesë nga vlera e shprehur në kontot 013, 014, 015 dhe 016.

Pozita nr. 009 me emrin **B I (2) - Tokë, objekte ndërtimore dhe mjete të tjera të cilat nuk shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë** paraqet mbledhje të vlerës së paraqitur në pozitat nr. 010, 011 dhe 012 dhe e njëjta ka të bëjë me tokë dhe objekte ndërtimore të cilat nuk janë të klasifikuara si investime të shoqërisë për sigurim në përputhje me SNK 40 – Investim në patundshmëri.

Në pozitën nr. 010 me emrin **B I (2.1) – Tokë** shprehet shuma e evidentuar në konton 020, si dhe pjesë nga vlera e shprehur në kontot 023, 024 dhe 025.

Në pozitën 011 me emrin **B I (2.2) – Objekte ndërtimore** shprehet shuma e evidentuar në konton 021, si dhe pjesa nga vlera e shprehur në konton 023, 024 dhe 025.

Në pozitën nr. 012 me emrin **B I (2.3) – Mjete materiale të tjera** shprehet shuma e evidentuar në konton 022 dhe 029, si dhe pjesa nga vlera e shprehur në kontot 023, 024 dhe 025.

Pozita nr. 013 me emrin **B II – INVESTIME FINANCIARE NË SHOQËRI NË GRUP – FILIALE, SHOQËRI TË BASHKANGJITURA DHE ENTITETE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLUARA** paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitat nr. 014, 015, 016, 017, 018, 019 dhe 020. Kjo pozitë i përfshin investimet financiare në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara. Në këtë pozitë paraqitet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në shoqëritë e tjera në të cilat shoqëria për sigurim posedon aksione me të drejtë të votës dhe pjesëmarrje në shumë më të madhe se 50% pronësi, gjegjësisht të drejtë të udhëheqjes në shoqërinë me çka realizohet pjesëmarrja me shumicë në shoqëri. Këto investime shoqëria për sigurim i vlerëson dhe paraqet në përputhje me SNK 27 – Raporte të konsoliduara dhe të veçanta financiare. Në investimet e shoqërisë për sigurim në shoqëri të bashkangjitura paraqiten investimet e shoqërisë për sigurim në shoqëri të tjera në të cilat shoqëria posedon aksione me të drejtë të votës dhe pjesëmarrje prej 20% deri 50% pronësi, gjegjësisht të drejtë të udhëheqjes në shoqëri, me çka realizohet pjesëmarrje e rëndësishme në veprimtarinë dhe politikën afariste të shoqërisë, e cila ka fituar aksionet dhe pjesëmarrje. Këto investime shoqëria i shpreh dhe vlerëson në raportet e veta financiare në përputhje me SNK 28 – Investime në entitetet e bashkangjitura. Në pozitën e njëjtë paraqiten edhe investimet në shoqëritë në të cilat shoqëria e sigurimeve ka pjesëmarrje. Këto investime shoqëria për sigurim i shpreh dhe vlerëson në përputhje me SNK 31 – Pjesëmarrje në investime të përbashkëta.

Në pozitën nr. 014 me emrin **B II (1) – Aksione, pjesëmarrje dhe instrumente të tjera me vlerë në shoqëri në grup – filiale** shprehet shuma e evidentuar në kontot 03002, 03012, 03022 dhe 03032.



Në pozitën nr. 015 me emër **BII (2) – Letra debitore me vlerë të cilat i ka emetuar shoqëria në grup – filiale dhe hua të shoqërive në grup – filiale** shprehet shuma e evidentuar në kontot 03000,03001, 03003,03010,03011, 03013, 03020,03021, 03023, 03030,03031 dhe 03033.

Në pozitën nr. 016 me emrin **B II (3) – Aksione, pjesëmarrje dhe instrumente të tjera pronësore me vlerë në shoqëri të bashkangjitura** shprehet shuma e evidentuar në kontot 03102,03112,03122 03102,03112,03122 dhe 03132

Në pozitën nr. 017 me emrin **B II (4) – Letra debitore me vlerë të cilat i kanë botuar shoqëritë e bashkangjitura dhe hua të shoqërive të bashkangjitura** shprehet shuma e evidentuar në kontot 03100, 03101, 03103, 03110, 03111, 03113, 03120, 03121, 03123, 03130, 03131 dhe 03133.

Në pozitën nr. 018 me emrin **B II (5) – Investime të tjera financiare në shoqëri në grup – filiale** shprehet shuma e evidentuar në kontot 03004, 03009, 03014, 03019, 03024, 03029, 03034 dhe 03039.

Në pozitën nr. 019 me emrin **B II (6) – Investime të tjera financiare në shoqëri të bashkangjitura** shprehet shuma e evidentuar në kontot 03104, 03109, 03114, 03119, 03124,03129, 03134 dhe 03139

Në pozitën nr. 020 me emrin **B II (7) – Investime në entitetet e përbashkëta të kontrolluara** shprehet shuma e evidentuar në konton 032.

Pozita nr. 21 me emrin **B III – INVESTIME TË TJERA FINANCIARE** paraqet shumën e vlerës së shprehur në pozitën nr. 022, 025, 030, 035 dhe 040. Kjo pozitë ka të bëjë me investimet e shoqërive për sigurim në instrumente financiare dhe mjete financiare, të klasifikuara në katër portofole, me qëllim të realizimit të të ardhurave. Trajtimi kontabilist i këtyre investimeve në përputhje me SNK – 39 – Instrumente financiare: njohje dhe matje. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar e grupeve konto 04, 05, 06, 07 dhe 08.

Pozita nr. 022 me emrin **B III (1) – Investime financiare të cilat ruhen deri në maturim** paraqet shumë të vlerave të shprehura në pozitën nr. 023 dhe 024. Në të njëjtën shprehet vlera e investimeve financiare të shoqërisë së sigurimeve në letra me vlerë dhe instrumente të tjera financiare të cilat shoqëria e sigurimeve në përputhje me SNK 39 – Instrumente financiare, njohje dhe matje dhe me politikën e saj të veprimtarisë, i ka klasifikuar në mjete financiare të cilat ruhen deri në maturim. Në këtë kategori shoqëria e sigurimeve mund t'i klasifikojë instrumentet të cilat kanë pagesa fikse apo të caktuara dhe maturim fiks dhe të cilat shoqëria ka për qëllim dhe mundësi t'i ruajë deri në maturim, përveç atyre të cilat shoqëria e sigurimeve gjatë njohjes fillestare i ka përcaktuar sipas vlerës objektive përmes Bilancit të suksesit, ato të cilat shoqëria e sigurimeve i ka klasifikuar si të disponueshme për shitje dhe ato të cilat e plotësojnë përkufizimin për hua dhe kërkesa në përputhje me SNK 39 – Instrumente financiare, njohje dhe matje. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në grupin konto 04.

Në pozitën 023 me emrin **B III (1.1.) – Letra debitore me vlerë me afat të maturimit deri në një vit** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në instrumente debitore (obligacione, regjistra shtetërorë, regjistra komerciale dhe letra të tjera me vlerë me rendiment fiks) me afat të maturimit deri në një vit të klasifikuara si të ruajtura deri në maturim. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 04000, 040010, 040100, 040110, 040200, 040210, 040280, 041000, 041010, 041100, 041110, 041200, 041210, 041290, 042000, 042010, 042100, 042110, 042200, 042290, 043000, 043010, 043100, 0431100, 043200, 043210, dhe 043290.

Në pozitën 024 me emrin **B III (1.2.) – Letra debitore me vlerë me afat të maturimit mbi një vit** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në instrumente debitore (obligacione, regjistra shtetërore, regjistra komerciale dhe letra të tjera me vlerë me rendiment fiks) me afat të maturimit mbi një vit, të klasifikuara si të ruajtura deri në maturim. Në këtë pozitë paraqitet vlera e shprehur në kontot 040001, 040011, 040101, 040111, 040201, 040211, 040291, 041001, 041011, 041101, 041111, 041201, 041211, 041291, 042001, 042011, 042101, 042111, 042201, 042211, 042291, 043001, 043011, 043101, 043111, 043201, 043211 dhe 043291.

Në pozitën nr. 025 me emrin **B III (2) – Investime financiare të disponueshme për shitje** paraqet shumën e vlerës së shprehur në pozitën nr. 026, 027, 027 dhe 029. Në të njëjtën shprehet vlera e investimeve financiare të shoqërisë të sigurimeve në letrat me vlerë dhe instrumente të tjera financiare (të cilat, në përputhje me SNK 39 – Instrumente financiare – njohje dhe matje dhe me politikën e saj të punës, shoqëria e siguirmeve i ka klasifikuar në mjete financiare të disponueshme për shitje. Në këtë pozitë janë të përfshira instrumentet të cilat nuk ruhen deri në maturim dhe të cilat nuk ruhen për tregti, gjegjësisht ato për të cilat nuk është i njohur qëllimi gjatë blerjes (mund të jenë lëndë e shitjes apo mund të ruhen deri në maturim). Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në grupin konto 05.

Në pozitën 026 me emrin **B III (2.1.) – Letra debitore me vlerë me afat të maturimit deri në një vit** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në instrumentet debitore (obligacione, regjistra shtetëror, regjistra komercial, dhe letra të tjera me vlerë me rendiment fiks) me afat të maturimit deri në një vit të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 050000, 050010, 050100, 050110, 050200, 050210, 050290, 051000, 051010, 051100, 051110, 051200, 051210, 051290, 052000, 052010, 052100, 052110, 052200, 052210, 052290, 053000, 053010, 053100, 053110, 053200, 053210 dhe 053290.

Në pozitën 027 me emrin **B III (2.2.) – Letra debitore me vlerë me afat të maturimit mbi një vit** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në instrumentet debitor (obligacione, regjistra shtetërore, regjistra komerciale, dhe letra të tjera me vlerë me rendiment fiks) me afat të dorëzimit mbi një vit të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Në këtë pozitë paraqitet vlera e shprehur në kontot 050001, 050011, 050101, 050111, 050201, 050211, 050291, 051001, 051011, 051101, 051111, 051201, 051211, 051291, 052001, 052011, 052101, 052111, 052201, 052211, 052291, 053001, 053011, 053101, 053111, 053201, 053211 и 053291.

Në pozitën 028 me emrin **B III (2.3.) – Aksione, pjesëmarrje dhe instrumente të tjera pronësore** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë së sigurimeve në instrumente pronësore (aksione dhe pjesëmarrje) të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Në këtë pozitë paraqitet vlera e shprehur në kontot 050002, 050012, 050212, 050292, 051002, 051012, 051202, 051212, 051292, 052002, 052012, 052212, 052292, 053002, 053012, 053202, 053212 dhe 053292.

Në pozitën 029 me emrin **B III (2.4.) – Aksione dhe pjesëmarrje në fondet investuese** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë së sigurimeve në aksione dhe pjesëmarrje në fondet investuese të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Në këtë pozitë paraqitet vlera e shprehur në kontot 05022, 05122, 05222 dhe 05322.

Pozita nr. 030 me emrin **B III (3) – Investime financiare për tregti** paraqet shumën e vlerave të shprehura në pozitën nr. 031, 032, 033 dhe 034. Në të njëjtën shprehet vlera e investimeve të shoqërisë së sigurimeve në letrat me vlerë instrumente financiare të tjera që shoqëria e sigurimeve, në përputhje me SNK 39 dhe me politikën e saj të punës, i ka klasifikuar në mjete financiare të cilat ruhen për tregti (sipas vlerës objektive përmes Bilancit të suksesit). Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar e grupit konto 06.

Në pozitën 031 me emrin **B III (3.1). Letra debitore me vlerë me afat të maturimit deri në një vit** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë së sigurimeve në instrumente debitore (obligacione, regjistra shtetërore, regjistra komerciale, dhe letra të tjera me vlerë me rendiment fiks) me afat të maturimit deri në një vit të klasifikuara në portofolin për tregti. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 060000, 060010, 060100, 060110, 060200, 060210, 060290, 061000, 061010, 061100, 061110, 061200, 061210, 061290, 062000, 062010, 062100, 062110, 062200, 062210, 062290, 063000, 063010, 063100, 063110, 063200, 063210 dhe 063290.

Në pozitën 032 me emrin **B III (3.2). Letra debitore me vlerë me afat të maturimit mbi një vit** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë së sigurimeve në instrumentet debitore (obligacione, regjistra shtetëror, regjistra komercial, dhe letra të tjera me vlerë me rendiment fiks) me afat të dorëzimit mbi një vit të klasifikuara në portofolin për tregti. Në këtë pozitë paraqitet shuma e shprehur në kontot 060001, 060011, 060101, 060111, 060201, 060211, 060291, 061001, 061011, 061101, 061111, 061201, 061211, 061291, 062001, 062011, 062101, 062111, 062201, 062211, 062291, 063001, 063011, 063101, 063111, 063201, 063211 dhe 063291.

Në pozitën 033 me emrin **B III (3.3.) – Aksione, pjesëmarrje dhe instrumente të tjera pronësore** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në instrumentet pronësore (aksione dhe pjesëmarrje) të klasifikuara në portofolin për tregti. Në këtë pozitë paraqitet vlera e shprehur në kontot 060002, 060012, 060212, 060292, 061002, 061012, 061202, 061212, 061292, 062002, 062012, 062212, 062292, 063002, 063012, 063202, 063212 dhe 063292.

Në pozitën 034 me emrin **B III (3.4.) – Aksione dhe pjesëmarrje në fondet investuese** shprehet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në aksione dhe pjesëmarrje në fondet investuese të klasifikuara në portofolin për tregti. Në këtë pozitë paraqitet vlera e shprehur në kontot 06022, 06122, 06222 dhe 06322.

Pozita nr. 035 shenja **B III (4) – Depozita, hua dhe plasmane të tjera** paraqet shumën e vlerës së parqitur në pozitën nr. 036, 037, 038 dhe 039. Në të njëjtën paraqitet vlera e investimeve të shoqërisë për sigurim në depozita (afatshkurte dhe afatgjate) në banka dhe institucionet e tjera kreditore, hua të dhëna (duke përfshirë depozitat dhe huatë me klauzula devizore, afatshkurte dhe afatgjate), kërkesat në bazë të garancive të dhëna dhe plasmane të tjera. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në grupin konto 08.

Në pozitën nr. 036 me emrin **B III (4.1.) – Depozita të dhëna** shprehet shuma e evidentuar në konton 080.

Në pozitën nr. 037 me emrin **B III (4.2.) – Hua të siguruara me hipotekë** shprehet shuma e evidentuar në konton 0810.

Në pozitën nr. 038 me emrin **B III (4.3.) – Hua të tjera** shprehet shuma e evidentuar në konton 0811.

Në pozitën nr. 039 me emrin **B III (4.4.) – Plasmane të tjera** shprehet shuma e evidentuar në kontot 083 dhe 089.

Pozita nr. 040 me emrin **B III (5) – Instrumentet financiare derivative** kanë të bëjë me instrumentet financiare derivative të ruajtura për tregti dhe instrumente financiare derivative të ruajtura për menaxhim me rrezikun. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në grupin konto 07.

Pozita nr. 041 me emrin **B IV – DEPOZITA TË SHOQËRISË PËR RISIGURIM TE CEDUESIT, NË BAZË TË KONTRATAVE PËR RISIGURIM** ka të bëjë me shumat e kërkesave të shoqërisë të sigurimeve të cilat kryejnë punë të risigurimit aktiv në bazë të depozitave të dhëna në shoqëritë ceduese. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 133.

Pozita nr. 042 me emrin **C – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet teknike bruto** paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitën nr. 043, 044, 045, 046, 047, 048 dhe 049. Në këtë pozitë paraqitet shuma e pjesës për risigurim në provigjonet teknike bruto e cila së bashku me shumat neto të provigjoneve teknike e krijojnë shumën bruto të provigjoneve teknike të shprehura në pozitën përkatës nga Pasiva e Bilancit të gjendjes – Provigjone teknike.

Në pozitën nr. 043 me emrin **C (1) – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonin bruto për prim transferues** shprehet pjesa për risigurim në gjithsej provigjonet bruto për prime transferuese. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 6001.

Në pozitën nr. 044 me emrin **C (2) – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonin matematik bruto** shprehet pjesa për risigurim në gjithsej provigjonin matematik bruto. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 6011.

Në pozitën nr. 045 me emrin **C (3) – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet bruto për dëme** shprehet pjesa për risigurim me gjithsej provigjonet bruto për dëme. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 6031 dhe 6041.

Në pozitën nr. 046 me emrin **C (4) – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet bruto për bonuse dhe lirime** shprehet pjesa nga risigurimi në gjithsej provigjonet teknike bruto që kanë të bëjnë me provigjonet për bonuse dhe lirime dhe shpreh shumën e evidentuar në konton 6051.

Në pozitën nr. 047 me emrin **C (5) – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonin bruto të barazimit** shprehet pjesa nga risigurimi në gjithsej provigjonet teknike bruto që kanë të bëjnë me provigjonet për bonuse dhe rabate dhe shprehet shuma e evidentuar në konton 6061.

Në pozitën nr. 048 shenja **C (6) – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet e tjera teknike bruto** shprehet pjesa nga risigurimi në gjithsej provigjonet e tjera teknike bruto. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 6071.

Në pozitën nr. 049 shenja **C (7) – Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në provigjonet teknike bruto për sigurim jete ku rreziku nga investimi është në kurriz të të siguruesit** shprehet pjesa për risigurim në gjithsej provigjonet teknike bruto të cilat ndahen në raport të kontratave për sigurim jete ku rreziku investues është në kurriz të siguruesit. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 6021.

Pozita nr. 050 me emër **Ç – INVESTIME FINANCIARE TE TË CILAT SIGURUESI E NDËRMERR RREZIKUN INVESTUES (KONTRATA PËR SIGURIM)** i përfshin investimet financiare të cilat shprehen, pranohen dhe vlerësohen në përputhje me SNK 39 – Instrumente financiare: njohje dhe matje, politikë të sjellë kontabiliste si dhe në përputhje me përcaktimet nga kontratat për sigurim. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në grupin konto 09.

Pozita nr. 051 me emër **D – MJETE TATIMORE TË ANULUARA DHE RRJEDHËSE** paraqet shumë të vlerave të paraqitura në pozitat 052 dhe 053.

Pozita 052 me emër **D (1) – Mjete tatimore të anuluar** ka të bëjë me shumën e tatimit të fitimit e cila mund të kompensohet në periudhat e ardhshme si dallime të përkohshme të cilat mund të refuzohen, si dhe lirime tatimore transferuese të pashfrytëzuara apo humbje të cilat vlerësohen në mënyrë kontabiliste në përputhje me SNK 12 – Tatim i fitimit. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 198.

Pozita 053 me emër **D (2) – Mjete tatimore rrjedhëse** ka të bëjë me shumën e tatimit të fitimit i cili duhet të paguhet në fitimin që është lëndë e tatimit për periudhën aktuale përlogaritëse e cila vlerësohet në mënyrë kontabiliste në përputhje me SNK 12 – Tatim i fitimit. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 170.

Pozita nr. 054 me emër **D – KËRKESA** paraqet shumë të vlerave të shprehura në pozitën nr. 055, 059, 063 dhe 067.

Pozita nr. 055 me emër **D I – KËRKESA NGA PUNËT DIREKTE TË SIGURIMIT** paraqet shumë të vlerave të paraqitura në pozitën nr. 056, 057 dhe 058. E njëjta i përfshin kërkesat nga të siguruarit dhe kërkesat nga përfaqësuesit, gjegjësisht ndërmjetësuesit në sigurim.

Pozita nr. 056 me emër **D I (1) – Kërkesa nga të siguruarit** i përfshin kërkesat e shoqërisë për sigurim në bazë të primit për sigurim nga të siguruarit në bazë të të gjitha kontratave të lidhura për sigurim. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 120, 121 dhe pjesa nga vlera e shprehur në konton 129.

Pozita nr. 057 me emër **D I (2) – Kërkesa nga ndërmjetësuesit** i përfshin kërkesat e shoqërisë për sigurim në bazë të primit për sigurim nga përfaqësuesit, gjegjësisht ndërmjetësuesit në bazë të kontratave të lidhura për sigurim dhe kthim të provizionit në bazë të kontratave të lidhura për sigurim. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konto 122 dhe pjesë nga vlera e shprehur në konto 129.

Pozita nr. 058 me emër **D I (3) – Kërkesa të tjera nga punët direkte të sigurimit** i përfshin kërkesat e tjera nga punët direkte të sigurimit të shoqërisë të sigurimeve. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 128 dhe pjesë nga vlera e shprehur në konton 129.

Pozita nr. 059 me emër **D II – KËRKESA NGA PUNËT E BASHKËSIGURIMIT DHE RISIGURIMIT** - paraqet shumë të vlerave të shprehura në pozitën nr. 060, 061 dhe 062. dhe i përfshin kërkesat e shoqërisë të sigurimeve, gjegjësisht risigurimeve në bazë të primit për bashkësigurim dhe risigurim, në bazë të pjesëmarrjes në kompensim të dëmeve nga bashkësigurimi dhe risigurimi dhe kërkesat e tjera nga aktivitetet e bashkësigurimit dhe risigurimit.

Pozita nr. 060 me emër **D II (1) – Kërkesat në bazë të primit për bashkësigurim dhe risigurim** i përfshin kërkesat në bazë të primit për bashkësigurim dhe risigurim aktiv. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 130, 131, 132 dhe pjesë nga vlera e shprehur në konton 139.

Pozita nr. 61 me emër **D II (2) – Kërkesa në bazë të pjesëmarrjes në kompensim të dëmeve nga bashkësigurimi dhe risigurimi** i përfshin kërkesat për pjesëmarrje në kompensim të dëmeve nga punët e bashkësigurimit dhe risigurimi aktiv. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 140, 141, 142 dhe pjesë nga vlera e shprehur në konton 149.

Pozita nr. 062 me emër **D II (3) – Kërkesa të tjera nga aktivitetet e bashkësigurimit dhe risigurimit** i përfshin kërkesat e tjera në bazë të aktiviteteve të bashkësigurimit dhe risigurimit. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 138 dhe pjesë nga vlera e paraqitur në kontot 139, 148 dhe 149.

Pozita nr. 063 me emër **D III – KËRKESA TË TJERA** paraqet shumë të vlerave të shprehura në pozitën nr. 064, 065 dhe 066 dhe i përfshin kërkesat nga aktivitetet e tjera të sigurimit, kërkesat në bazë të rendimenteve nga investimet dhe kërkesat e tjera.

Pozita nr. 064 me emër **D III (1) – Kërkesa të tjera nga punët direkte të sigurimit** i përfshin kërkesat e shoqërisë për sigurim në bazë të së drejtës së regresit, kërkesës nga shoqëritë e tjera për sigurim në bazë të dëmeve të paguara me shërbim, kërkesat në bazë të kompensimit për dëme të paguara me shërbim, kërkesë nga Fondi garantues në bazë të dëmeve të shkaktuara nga mjete motorike të panjohura dhe jo të siguruara, kërkesë në bazë të provizionit nga risigurimi, kërkesa në bazë të paradhënieve të dhëna dhe kërkesave të tjera. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar e grupit me konto 15.

Pozita nr. 065 me emër **D III (2) – Kërkesa në bazë të investimeve financiare** i përfshin kërkesat e shoqërisë të sigurimeve në bazë të interesave, dividendave, pjesëmarrje në fitim, të ardhura nga huatë dhe ngjashëm. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në grupin konto 16.

Pozita nr. 066 me emër **D III (3) – Kërkesa të tjera** i përfshin kërkesat e tjera nga veprimtaria, siç janë kërkesa në bazë të tatimeve, kërkesa nga të punësuarit, kërkesa nga blerësit, kërkesa në bazë të depozitave të dhëna, paradhënieve dhe garanci dhe kërkesa të tjera nga veprimtaria. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar e kontove 171, 172, 173, 174, 175, 179, si dhe pjesë nga vlera e evidentuar në konton 178.

Pozita nr. 067 me emër **D IV – KËRKESA NË BAZË TË KAPITALIT JO TË PAGUAR TË SHKRUAR** ka të bëjë me kërkesat për kapital i cili ende nuk është paguar (në tërësi apo pjesërisht) nga ana e aksionarëve gjatë emetimit të aksioneve të shoqërisë së sigurimeve. Në këtë pozitë shprehet pjesa nga shuma e evidentuar në konton 178.

Pozita nr. 068 me emër **E- MJETE TË TJERA** paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitën nr. 069, 072 dhe 077.

Pozita nr. 069 me emër **E I – MJETE MATERIALE TË CILAT SHËRBEJNË PËR KRYERJE TË VEPRIMTARISË (PËRVEÇ TOKË DHE OBJEKTE NDËRTIMORE)** paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitën nr. 070 dhe 071.

Pozita nr. 070 me emër **E I (1) – Pajisje** ka të bëjë me pajisje të cilat shoqëria e sigurimeve i shfrytëzon për kryerje të veprimtarisë. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 012, si dhe pjesë nga vlera e shprehur në kontot 013, 014, 015 dhe 016.

Pozita nr.071 me emër **E I (2) - Mjete materiale të tjera**. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 019 si dhe pjesë nga vlera e shprehur në konton 013, 014, 015 dhe 016.

Pozita nr. 072 me emër **E II – MJETE TË PARAVE DHE EKVIVALENTE TË TJERA TË PARAVE** paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitën nr. 073, 074, 075 dhe 076.

Pozita nr. 073 me emër **E II (1) – Mjete të parave në bankë** ka të bëjë me mjetet e parave të shoqërisë për sigurim në llogaritë e punës në bankat e autorizuara për kryerje të qarkullimit pagesor. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 100, 102 dhe 104.

Në pozicionin nr. 074 me emër **E II (2) – Mjete të parave në arkë** shprehet shuma e evidentuar në kontot 103 dhe 105.

Pozita nr. 075 me emër **E II (3) – Mjete të parave të ndara për mbulim të provigjonit matematik** ka të bëjë me mjetet e parave të shoqërisë të sigurimeve të llogarive të veçanta të hapura në bankat e autorizuara për kryerje të qarkullimit pagesor, përmes të cilave shoqëria e sigurimeve pranon dhe kryen pagesa në lidhje me punët e lidhura me mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 101.

Pozita nr. 076 me emër **E II (4) – Mjete të tjera monetare dhe ekuivalente të tjera monetare** i përfshin mjetet e tjera të parave, çeqet, kambialet dhe ekuivalentet e tjera të parave. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar e kontos 106, 109, 110, 111, 112 dhe 119.

Në pozitën nr. 077 me emër **E III – REZERVA DHE INVENTAR I VOGËL** shprehet shuma e evidentuar në klasën konto 3.

Pozita nr. 078 me emër **F – PËRKUFIZIME AKTIVE KOHORE** ka të bëjë me përkufizimet aktive kohore të shoqërive të sigurimeve të periudhave të ardhshme përlllogaritëse. Kjo pozitë paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitën nr. 079, 080 dhe 081. Në të njëjtën shprehen të ardhurat e llogaritura paraprakisht, shpenzimet e anuluar dhe përkufizimet aktive kohore të tjera.

Pozita nr. 079 me emër **F (1) – Të ardhura të përlllogaritura më parë në bazë të interesit dhe huazimeve** paraqet përkufizim aktiv kohor të të ardhurave të llogaritura më parë në bazë të interesit dhe huazimeve. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton kolektive 190.

Pozita nr. 080 me emër **F (2) – Shpenzime të anuluarra për blerje të policave paraqet përkufizim aktiv kohor të shpenzimeve të paguara paraprakisht për blerje të policave të sigurimit. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton kolektive 192.**

Pozita nr. 081 me emër **F (3) – Të ardhurat e tjera të llogaritura dhe shpenzimet e anuluarra kanë të bëjnë me të gjitha përkufizimet e tjera aktive kohore të shoqërisë të sigurimeve. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot kolektive 191, 193 dhe 199.**

Pozita nr. 082 me emër **G – MJETE JO RRJEDHËSE TË CILAT RUHEN PËR SHITJE DHE PUNË TË NDËRPRERË** i përfshin investimet në mjete materiale dhe jomateriale të cilat i plotësojnë kriteret për klasifikim që të ruhen për shitje (apo përfshihen në grupin për tjetërsim të klasifikuara se si të ruhen për shitje), në përputhje me SNRF 5 – Mjetet jo rrjedhëse të cilat ruhen për shitje dhe punë të ndërprera. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 082.

Pozita nr. 083 me emër **GJ – GJITHSEJ AKTIVA** paraqet shumë të të gjitha pozitave të shprehura në aktivën, gjegjësisht shumën e vlerës së shprehur në pozitat nr. 001, 004, 042, 050, 051, 054, 068, 078 dhe 082 (A+B+C+Ç+D+DH+E+F).

Pozita nr. 084 me emër **H – EVIDENCË JASHTËBILANCORE – AKTIVA** ka të bëjë me kërkesat regres të porealizuara, garanci të dhëna, letra me vlerë dhe letra potenciale me vlerë, investime dhe fitime potenciale dhe norma tjera aktive jashtëbilancore. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot kolektive 990, 991, 992, 993 dhe 994.

## PASIVA

Pozita nr. 085 me emër **A – KAPITAL DHE PROVIGJONE** paraqet shumën e vlerës së shprehur nga Pozita nr. 086, 090, 091, 095, 101 dhe 103 ndërsa e zvogëluar për vlerën e shprehur në pozitat 102 dhe 104. E njëjta ka të bëjë me lartësinë dhe shumën e kapitalit pronësor të shoqërisë e cila është e përbërë nga shuma e kapitalit të shkruar (aksionar), primi i aksioneve të emetuara (provigjone të kapitalit), provigjone të rivelerësimit, fitim jo i shpërndarë neto apo humbja e transferuar dhe humbja apo fitimi për periudhën rrjedhëse përlllogaritëse.

Pozita nr. 086 me emër **A I – KAPITAL I REGJISTRUAR** ka të bëjë me kapitalin e shkruar aksionar të shoqërisë për sigurim i cili duhet të paguhet në tërësi me të holla dhe i njëjti nuk guxon të jetë më i ulët nga shuma e vërtetuar me ligj. Kjo pozitë paraqet shumë nga vlerat e paraqitura në pozitën nr. 087, 088 dhe 089. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 900, 901 dhe 902.

Në pozitën nr. 087 me emër **A I (1) – Kapital i regjistruar nga aksionet e thjeshta** shprehet shuma e evidentuar në konton 900.

Në pozitën nr. 088 me emër **A I (2) – Kapital i regjistruar nga aksionet prioritare** shprehet shuma e evidentuar në konton 901.

Në pozitën nr. 089 me emër **A I (3) – Kapital i regjistruar por jo i paguar** ka të bëjë me kapitalin i cili ende nuk është paguar nga ana e aksionarëve të shoqërisë të sigurimeve. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 902.



Pozita nr. 090 me emër **A II – PRIME TË AKSIONEVE TË EMETUARA** ka të bëjë me pjesën nga kapitali i regjistruar i shoqërisë i cili paraqet shumë e cila paraqitet si rezultat i shitjes së aksioneve për çmim më të lartë nga vlera e tyre nominale (provigjoni kapital). Ka të bëjë me dallimin ndërmjet vlerës nominale dhe shitëse të aksioneve. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar e kontos 910 dhe 911.

Pozita nr. 091 me emër **A III – PROVIGJONI I RIVLERËSIMIT** paraqet korrigjimin e kapitalit aksionar, gjegjësisht përshtatshërisë së kapitalit aksionar e cila kryhet në kushte të inflacionit me qëllim mbrojtjen e mjeteve të pronarëve. Rivlerësimi paraqet përshtatshmëri të vlerës nominale të pozitave monetare dhe jo monetare të aktivës dhe kapitalit aksionar për shkak të ndryshimit të çmimit të produkteve. Rivlerësimi del nga përshtatshmëria e vlefshme e normave individuale të mjeteve të shoqërisë për sigurim (patundshmëri, mjete financiare) në përputhje me trajtimin e tyre kontabilist, në përputhje me SNK 39 – Instrumente financiare: njohja dhe matja dhe SNK 16: Patundshmëri, strehimore dhe pajisje. Kjo pozitë paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën nr. 092, 093 dhe 094.

Pozita nr. 092 me emër **A III (1) – Mjete materiale** paraqet fitim jo të realizuar, gjegjësisht humbje e cila del nga përshtatshmëria e vlefshme të mjeteve materiale të cilat shoqëria i shfrytëzon për kryerjen e veprimtarisë, trajtimi kontabilist i së cilës është në përputhje me SNK 16 – Patundshmëri, strehimore dhe pajisje. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 931.

Pozita nr. 093 me emër **A III (2) – Investime financiare** paraqet fitim/humbje jo të realizuar i cili del nga përshtatshmëria e vlefshme e investimeve financiare të klasifikuara në portofolin të disponueshme për shitje të cilat në aspekt kontabilist janë trajtuar në përputhje me SNK 39 – Instrumente financiare: njohje dhe matje. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 932.

Pozita nr. 094 me emër **A III (3) – Provigjone të tjera të rivlerësimit** paraqet fitim/humbje jo të realizuar i cili del nga përshtatshmëria e vlefshme e mjeteve të tjera (p.sh. mjete jo materiale). Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 939 dhe 930.

Pozita nr. 095 me emër **A IV – PROVIGJONE** ka të bëjë me provigjonet e shoqërive për sigurim) të cilat ndahen nga fitimi i shoqërisë të sigurimeve pas tatimit. Të njëjtat mundet të jenë ligjore (obligime të cilat dalin nga ligji), statutare (në përputhje me statutin e shoqërisë) dhe provigjone të tjera në varësi nga nevojat e shoqërisë (përveç provigjoneve të rivlerësimit). Kjo pozitë paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën nr. 096, 097, 098 dhe 100 ndërsa e zvogëluar për vlerën e shprehur në pozitën 0.99.

Pozita nr. 096 me emër **AIV (1) – Provigjone ligjore** ka të bëjë me provigjonet e shoqërisë të cilat është e detyruar t'i ndajë në përputhje me nenin 70 të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimit. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 9210.

Pozita nr. 097 me emër **A IV (2) – Provigjone statutare** ka të bëjë me provigjonet të cilat shoqëria mundet t'i ndajë dhe shfrytëzojë vetëm për qëllim të caktuar me Statutin e shoqërisë. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 9212.

Në pozitën nr. 098 me emër **A IV (3) – Provigjone për aksione personale** shprehet shuma e evidentuar në konton kolektive 9211.

Në pozitën nr. 099 me emër **A IV (4) – Aksione personale të blera** shprehet shuma e evidentuar në konton kolektive 922. Kjo pozitë paraqet paragraf refuzues të kapitalit.

Pozita nr. 100 me emër **A IV (5) – Provigjone të tjera** ka të bëjë me provigjonet e tjera të cilat shoqëria i formon nga fitimi neto, në varësi nga nevojat e saj. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton kolektive 9213.

Pozita nr. 101 me emër **A V – FITIMI JO I SHPËRNDARË NETO** ka të bëjë me fitimin e realizuar nga periudhat e mëparshme i transferuar në periudhën aktuale. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 940. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 940.

Pozita nr. 102 me emër **A VI – HUMBJE E TRANSFERUAR** ka të bëjë me humbjen e realizuar nga periudhat e mëparshme të transferuara në periudhën aktuale. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 941.

Pozita nr. 103 shenja **A VII – FITIM PËR PERIUDHËN AKTUALE PËRLLOGARITËSE** ka të bëjë në rezultatin financiar të shoqërisë të realizuar në periudhën e fundit përllogaritëse. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 950.

Pozita nr. 104 me emër **A VIII (1) – HUMBJE PËR PERIUDHËN AKTUALE PËRLLOGARTIËSE** ka të bëjë me fitimin e realizuar në periudhën e fundit përllogaritëse. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 951.

Pozita nr. 105 me emër **B – OBLIGIME TË NËNRENDITURA** paraqet obligim për instrumentet e nënrenditura financiare (p.sh. hua e nënrenditur). Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 247.

Pozita nr. 106 me emër **C – PROVIGJONE TEKNIKE** paraqet shumën nga Pozita nr. 107, 108, 109, 110, 111 dhe 112 dhe ka të bëjë me provigjonet teknike të shoqërisë të dedikuara për mbulim të obligimeve të ardhshme sipas kontratave të lidhura për sigurim. Në këto pozita paraqiten shumat bruto.

Pozita nr. 107 me emër **C I – Provigjone bruto për prime transferuese** shprehet shuma bruto e provigjoneve për prime transferuese. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 6000.

Pozita nr. 108 me emër **C II – Provigjoni matematik bruto** shprehet shuma bruto e provigjonit matematik të cilin shoqëria është e detyruar të ndajë në raport të kontratave për sigurim jete. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 6010.

Pozita nr. 109 me emër **C III – Provigjoni bruto për dëme** shprehet shuma bruto e provigjoneve për dëme, gjegjësisht provigjone për dëme të paraqitura të pazgjdhura dhe provigjone për dëme të ndodhura por jo të paraqitura. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar e kontove 6030 dhe 6040.

Pozita nr. 110 me emër **C IV – Provigjone bruto për bonuse dhe lirime** shprehet shuma bruto e provigjoneve për bonuse dhe lirime. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 6050.

Pozita nr. 111 me emër **C V – Provigjoni bruto i barazimit** shprehet shuma bruto e provigjonit të barazimit. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 6060.

Pozita nr. 112 me emër **C VI – Provigjonet e tjera teknike bruto** shprehet shuma bruto e provigjoneve të tjera teknike. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 6070.

Në pozitën nr. 113 me emër **Ç – PROVIGJONE TEKNIKE BRUTO NË RAPORT ME KONTRATAT TE TË CILAT I SIGURUARI E MERR RREZIKUN INVESTUES** shprehet shuma bruto e provigjoneve teknike në raport me kontratat te të cilat i siguruari e merr rrezikun investues. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 6020.

Pozita nr. 114 me emër **D – PROVIGJONE TË TJERA** paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën nr. 115 dhe 116.

Pozita nr. 115 me emër **D (1) – Provigjone për të punësuarit** paraqet ndarje të fitimit nga ana e shoqërisë nga fitimi pas tatimit për pensione dhe obligime të ngjashme ndaj të punësuarve. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 250, 251, 252 dhe pjesë nga konto 259.

Pozita nr. 116 me emër **D (2) – Provigjone të tjera** paraqet ndarje nga fitimi pas tatimit sipas nevojave të shoqërisë për sigurim. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 253, 254, 255 dhe pjesë nga konto 259.

Pozita 117 me emër **DH – OBLIGIME TATIMORE TË ANULUARA DHE RRJEDHËSE** paraqet shumë të shprehur në pozitat 118 dhe 119.

Pozita 118 me emër **DH (1) – Obligime tatimore të anuluar** ka të bëjë me shumën e tatimit të fitimit e cila duhet të paguhet në periudhën e ardhshme që ka të bëjë me dallimet e tatueshme të parakohshme. Në mënyrë kontabiliste vlerësohen në përputhje me SNK 12- Tatim i fitimit. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 295.

Pozita 119 me emër **DH (2) – Obligime tatimore rrjedhëse** ka të bëjë me shumën e tatimit të fitimit e cila duhet të paguhet në fitimin i cili është lëndë e tatimit për periudhën aktuale përlllogaritëse të cilat vlerësohen në mënyrë kontabiliste në përputhje me SNK 12- Tatim i fitimit. Tatimi aktual për periudhën aktuale dhe të kaluar duhet të njihet si obligim në lartësinë në të cilën i njëjti nuk është paguar. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 280.

Në pozitën nr. 120 me emër **E – OBLIGIM I CILI DEL NGA DEPOZITAT E SHOQËRISË PËR RISIGURIM TE CEDUESIT, NË BAZË TË KONTRATAVE PËR RISIGURIM** shprehet shuma e evidentuar në konton 212.

Pozita nr. 121 me emër **F – OBLIGIME** – paraqet shumë nga pozita nr. 122, 126 dhe 130.

Pozita nr. 122 me emër **F I – Obligime nga punët direkte të sigurimit** paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën nr. 123, 124 dhe 125 dhe ka të bëjë me obligimet të cilat dalin nga kryerja e punëve të sigurimit të shoqërisë për sigurim, gjegjësisht obligimet në bazë të pagesës së dëmeve.

Në pozitën 123 me emër **F I (1) – Obligime ndaj të siguruarve** shprehet shuma e evidentuar në kontot 200 dhe 201.

Në pozitën 124 me emër **F I (2) – Obligime ndaj përfaqësuesve dhe ndërmjetësuesve** shprehet shuma e evidentuar në konton 202.

Në pozitën 125 me emër **F I (3) – Obligime të tjera nga punët direkte të sigurimit** shprehet shuma e evidentuar në konton 209.

Pozita nr. 126 me emër **F II – Obligime nga punët e bashkësigurimit dhe risigurimit** paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën nr. 127, 128 dhe 129 dhe ka të bëjë me obligimet në bazë të primit për bashkësigurim dhe risigurim, obligimet në bazë të pjesëmarrjes në kompensimin e dëmeve dhe obligimeve të tjera të cilat dalin nga punët e bashkësigurimit dhe risigurimit.

Në pozitën 127 me emrin **F II (1) – Obligime në bazë të primit për bashkësigurim dhe risigurim** shprehet shuma e evidentuar në konton 210 dhe 211.

Në pozitën 128 me emrin **F II (2) – Obligime në bazë të pjesëmarrjes në kompensim të dëmeve** shprehet shuma e evidentuar në konton 220, 221 dhe 222.

Në pozitën 129 me emrin **F II (3) – Obligime të tjera nga punët e bashkësigurimit dhe risigurimit** shprehet shuma e evidentuar në konton 219 dhe 229.

Pozita nr. 130 me emrin **F III – Obligime të tjera** paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën nr. 131, 132 dhe 133 dhe ka të bëjë me obligimet të cilat dalin nga punët direkte të sigurimit, obligimet në bazë të financimit dhe obligimet e tjera të shoqërisë për sigurim.

Në pozitën 131 emri **F III (1) – Obligime të tjera nga punët direkte të sigurimit** shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 23.

Në pozitën 132 emri **F III (2) – Obligime në bazë të investimeve financiare** shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 24.

Në pozitën 133 emri **F III (3) – Obligime të tjera** shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 27, si dhe në kontot 281, 282, 283, 284, 285, 286 dhe pjesë nga vlera e shprehur në konton 289.

Pozita nr. 134 me emër **G – PËRKUFIZIME PASIVE KOHORE** ka të bëjë me përkufizimet pasive kohore të shpenzimeve të llogaritura por të anuluar, të ardhura të llogaritura për periudha të ardhshme, njohje e anuluar e të ardhurave për të cilat ekziston pasiguri për pagesë, provizione direkte të përlllogaritura, provizion i anuluar për risugrim, shpenzime të tjera të përlllogaritura dhe të ardhura të anuluar. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në kontot 290, 291, 292, 293, 294 dhe 296.

Në pozitën nr. 135 shenja **H – MJETE JO RRJEDHËSE TË CILAT RUHEN PËR SHITJE DHE PUNË TË NDËRPRERË** shprehet pjesa nga shuma e evidentuar në konton 289.

Pozita nr. 136 shenja **I – GJITHSEJ PASIVA** paraqet shumë të të gjitha pozitave të shprehura në pasivën, gjegjësisht shumë të vlerës së shprehur në pozitat nr. 085, 105, 106, 113, 114, 117, 120, 121, 134 dhe 135 (A+B+C+Ç+D+DH+E+Ë+F).

Pozita nr. 137 shenja **J – EVIDENCË JASHTË BILANCORE - PASIVA** ka të bëjë me kërkesat jo të realizuara regresore, garanci të dhëna, letra me vlerë dhe letra potenciale me vlerë, investime dhe fitim potencial dhe norma të tjera pasive jashtëbilancore. Në këtë pozitë paraqitet shuma e evidentuar në konton 995, 996, 997, 998 dhe 999.

## 2. RAPORT PËR FITIMIN GJITHPËRFSHIRËS (BILANCI I SUKSESIT)

### 2.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në raportin për fitimin gjithpërfshirës (Bilanci i suksesit) shprehen të ardhurat, shpenzimet, të dalat, ndryshimet në provigjonet teknike dhe rezultati financiar gjithpërfshirës i shoqërive për sigurim për periudhën akutale dhe të mëparshme për të cilën përgatitet bilanci i suksesit.

Gjatë përpilimit të Raportit për fitim gjithpërfshirës (Bilanci i suksesit) në kolonën 4 futen të dhënat për vitin aktual të punës ndërsa në kolonën 5 futen të dhënat për vitin e kaluar të punës.

### 2.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIM të pozitave individuale në Raportin për fitimin gjithpërfshirës (Bilanci i suksesit)

Në pozitën nr. 200 me emër **A – TË ARDHURAT NGA VEPRIMTARIA** shprehen gjithsej të ardhurat nga puna e shoqërisë të sigurimeve. Kjo pozitë paraqet shumën e pozitave nr. 201, 210, 223a, 224 dhe 225.

Në pozitën nr. 201 me emër **I – PRIM I FITUAR (TË ARDHURAT-NETO NGA PRIMI)** shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 70.

Pozita nr. 202 me emër **I (1) – Prim i shkruar bruto për sigurim** ka të bëjë me primin e shkruar bruto për sigurim. Primi i shkruar bruto për sigurim jo jetë i përfshin të gjitha shumat e primit të cilat janë të dakorduara (shkruara) gjatë periudhës aktuale përlogaritëse, pa dallim se të njëjtat në tërësi apo pjesërisht kanë të bëjnë me periudhën e ardhshme përlogaritëse. Lirimet financiare të cilat i jep shoqëria nuk janë norma refuzuese nga primi i shkruar bruto. Primi i shkruar bruto për sigurim në klasat e jetës, gjegjësisht primi i shkruar bruto për sigurime shtesë nga sigurimi në klasat e jetës i përfshin të gjitha shumat e primit për sigurim të cilat janë të maturuara (në bazë të dispozitave nga marrëveshja për sigurim) në periudhën aktuale përlogaritëse në raport me të gjitha kontratat aktive për sigurim. Primi i shkruar bruto për sigurim në klasat e jetës, gjegjësisht primi i shkruar bruto për sigurime shtesë nga sigurimi në klasat e jetës, përfshin: prim i paguar një herë sipas kontratave për sigurim që kanë hyrë në fuqi gjatë periudhës përlogaritëse apo kësti i primit i cili ka arritur për pagesë gjatë periudhës përlogaritëse në rast kur në përputhje me kontratën për sigurim është darkoduar pagesë e shumëfishtë e primit. Lirimet financiare të cilat i jep shoqëria nuk janë norma refuzuese nga primi i shkruar bruto. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 700.

Pozita nr. 203 me emër **I (2) – Prim i shkruar bruto për bashkësigurim** ka të bëjë me primin e shkruar bruto të pranuar në bashkësigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 701.

Pozita nr. 204 me emër **I (3) – Prim i shkruar bruto për risigurim dhe retrocesion** ka të bëjë me primin bruto të shkruar të pranuar në risigurim, gjegjësisht retrocesion. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 702.

Pozita nr. 205 me emër **I (4) – Prim i shkruar bruto i dorëzuar në bashkësigurim** ka të bëjë me pjesën nga primi i shkruar bruto në raport me punët e sigurimit të dorëzuara në bashkësigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 703.

Pozita nr. 206 me emër **I (5) – Prim i shkruar bruto i dorëzuar në risigurim** ka të bëjë me pjesën nga primi i shkruar bruto në raport me punët e sigurimit të dorëzuara në risigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 704.

Pozita nr. 207 me emër **I (6) – Ndryshim në provigjonin bruto për prim transferues** paraqet dallimin ndërmjet provigjonit bruto për prim transferues në fund dhe provigjonin bruto për prim transferues në fillim të periudhës përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 705.

Pozita nr. 208 me emër **I (7) – Ndryshim në provigjonin bruto për prim të transferuar – pjesë për bashkësigurim** paraqet dallimin ndërmjet provigjonit bruto për prim transferues – pjesë për bashkësigurim në fund dhe provigjonit bruto për prim transferues – pjesë për bashkësigurim në fillim të periudhës përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 706.

Pozita nr. 209 me emër **I (8) – Ndryshim në provigjonin bruto për prim transferues – pjesë për risigurim** paraqet dallimin ndërmjet provigjonit bruto për prim transferues – pjesë për risigurim në fund dhe provigjonit bruto për prim transferues – pjesë për risigurim në fillim të periudhës përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 707.

Pozita 210 me emër **II – TË ARDHURA NGA INVESTIMET** i përfshin të ardhurat të cilat realizohen në bazë të investimeve (dividenda, pjesëmarrje në fitim, rritje të vlerës etj). Kjo pozitë paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën nr. 211, 212, 216, 217, 218, 219 dhe 223.

Pozita nr. 211 me emër **II (1) – Të ardhurat nga filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara** i përfshin të ardhurat e realizuara nga filiale, shoqëritë e bashkangjitura dhe entitetet e përbashkëta të kontrolluara. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar e kontos kolektive 7200, 7210, 7220, 7230, 7240, 7250, 7260, 7270 dhe pjesë nga shuma e evidentuar në konton 729.

Pozita nr. 212 me emër **II (2) – Të ardhura nga investimet në toka dhe objekte ndërtimore** ka të bëjë me të ardhurat e realizuara të shoqërisë të sigurimeve, në bazë të investimeve në tokë dhe objekte ndërtimore. Përfshin të ardhura nga qiratë, të ardhura nga rritjet e vlerës së tokës dhe objekteve ndërtimore dhe të ardhurat nga shitja e tokës dhe objekteve ndërtimore, gjegjësisht shumë e vlerës së shprehur në pozitën nr. 213, 214 dhe 215.

Pozita nr. 213 me emër **II (2.1) – Të ardhurat nga qiratë** kanë të bëjnë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve të realizuara në bazë të tokës dhe objekteve ndërtimore të dhëna nën qira. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 7279.

Pozita nr. 214 me emër **II (2.2) – Të ardhura nga rritjet e vlerës së tokës dhe objekteve ndërtimore** ka të bëjë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve të cilat dalin nga rivlerësimi i tokës dhe objekteve ndërtimore. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 7245.

Pozita nr. 215 me emër **II (2.3) – Të ardhura nga shitja e tokës dhe objekteve ndërtimore** ka të bëjë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve të realizuara në bazë të shitjes së tokës dhe objekteve ndërtimore. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 7263.

Pozita nr. 216 me emër **II (3) – Të ardhura nga interesi** ka të bëjë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve të realizuara në bazë të interesave të investimeve financiare (p.sh., të ardhura interesi nga obligacionet, hua të dhëna, depozita dhe ngjashëm). Në mënyrë kontabiliste trajtohen në përputhje me SNK 18: Të ardhurat. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 7201,

7202, , 7203, 7204, 7205, 7206 dhe 7209.

Pozita nr. 217 me emër **II (4) – Dallimet pozitive të kursit** kanë të bëjnë me dallimet pozitive të kursit të cilat dalin nga ndryshimet e kursit të mesëm të valutave të huaja gjatë përlllogaritjes së vlerës së investimeve të shoqërive të sigurimeve. Të njëjtat trajtohen në mënyrë kontabiliste në përputhje me SNK 21: Efektet nga ndryshimi i kursit devizor. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 7221, 7222, 7223, 7224, 7225, 7226 dhe 7229.

Pozita nr. 218 me emër **II (5) – Përshtatshmëri e vlerës (fitime të porealizuara, matjen e vlerës objektive)** ka të bëjë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve që dalin nga përshtatshmëria e vlerës së investimeve të klasifikuara në portofolin për tregti (sipas vlerës objektive). Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 7251, 7252, 7253 dhe 7259.

Pozita nr. 219 me emër **II (6) – Fitimet e realizuara nga shitja e pronës financiare – fitim kapital** ka të bëjë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve, gjegjësisht risigurim të realizuara nga shitja e investimeve financiare. Përfshin investime financiare të disponueshme për shitje, investimet financiare për tregti (sipas vlerës objektive) dhe investime të tjera financiare. Kjo pozitë paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitat nr. 220, 221 dhe 222.

Pozita nr. 220 me emër **II (6.1) – Investime financiare të disponueshme për shitje** ka të bëjë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve, gjegjësisht risigurim të realizuara me shitje të investimeve financiare të klasifikuara në portofolin për shitje. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 7261.

Pozita nr. 221 me emër **II (6.2) – Investime financiare për tregti (sipas vlerës objektive)** ka të bëjë me të ardhurat e shoqërive të sigurimeve, gjegjësisht risigurimeve të realizuara me shitje të investimeve financiare të klasifikuara në portfolin sipas vlerës objektive. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 7262.

Pozita nr. 222 me emër **II (6.3) – Investime të tjera financiare** ka të bëjë me të gjitha të ardhurat e tjera nga shitja e investimeve financiare të shoqërive të sigurimeve, gjegjësisht risigurime. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar e kontos kolektive 7269.

Pozita nr. 223 me emër **II (7) Të ardhura të tjera nga investimet** ka të bëjë me të gjitha të ardhurat e tjera nga investimet e shoqërive të sigurimeve. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar e kontos kolektive 7211, 7231, 7232, 7239, 7241, 7242, 7243, 7244, 7249 dhe pjesë nga shuma e evidentuar në konto 729.

Pozita nr. 223a me emër **III – TË ARDHURA NË BAZË TË PROVIZIONEVE NGA RISIGURIMI** ka të bëjë me të ardhurat e realizuara në bazë të provizionit për risigurim dhe pjesëmarrje të tjera në fitim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 710.

Pozita nr. 224 me emër **IV – TË ARDHURA TË TJERA TEKNIKE-SIGURUESE, TË ZVOGËLUARA PËR RISIGURIM** ka të bëjë me të ardhurat e realizuara nga vlerësimi i dëmeve, të ardhurat në bazë të dëmeve të paguara në bazë të mjeteve motorike jo të siguruara dhe të panjohura dhe të ardhura të ngjashme teknike-siguruese të shoqërisë për sigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 71, përveç konto 710.

Pozita nr. 225 me emër **V – TË ARDHURA TË TJERA** ka të bëjë me të ardhurat e tjera të shoqërisë të pashprehura në pozita të tjera. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 73.

Në pozitën nr. 226 me emër **B – SHPENZIMET NGA VEPRIMTARIA** shprehen shpenzimet totale nga veprimtaria e shoqërisë të sigurimeve. Kjo pozitë paraqet shumë të pozitave nr. 228, 236, 246, 249, 252, 271, 281, 284 dhe 285.

Në pozitën nr. 227 me emër **I – DËME TË NDODHURA (NETO SHPENZIMET PËR DËME)** shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 40.

Pozita nr. 228 me emër **I (1) – Dëme të paguara bruto** ka të bëjë me dëmet e paguara bruto, gjegjësisht kompensimet për dëme, shuma të sigurimit dhe shuma të tjera të dakorduara të cilat u paguhen të siguruarve, gjegjësisht shfrytëzuesve të sigurimit në bazë të të gjitha kontratave të lidhura për sigurim, bashkësigurim dhe risigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 400.

Pozita nr. 229 me emër **I (2) – Zvogëlim për të ardhurat nga kërkesat e realizuara regresore bruto** kanë të bëjë me të ardhurat e realizuara në bazë të kërkesave të realizuara regresore dhe mbetjet e shpëtuara nga prona e siguar. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 401.

Pozita nr. 230 me emër **I (3) – Dëme të paguara bruto – pjesë për bashkësigurim** ka të bëjë me pjesën e bashkësigurimit në dëmet e paguara bruto. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 402.

Pozita nr. 231 me emër **I (4) – Dëme të paguara bruto – pjesë për risigurim/retrocesion** ka të bëjë me pjesën e risigurimit në dëmet e paguara bruto. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 403.

Pozita nr. 232 me emër **I (5) – Ndryshime në provigjonet për dëme bruto** e paraqet dallimin ndërmjet provigjoneve për dëme bruto në fund dhe provigjoneve për dëme bruto në fillim të periudhës përlogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 404.

Pozita nr. 233 me emër **I (6) – Ndryshime në provigjonet për dëme bruto – pjesa për bashkësigurim** e paraqet dallimin ndërmjet provigjoneve për dëme bruto – pjesë për bashkësigurim në fund dhe provigjone për dëme bruto – pjesë për bashkësigurim në fillim të periudhës përlogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 405.

Pozita nr. 234 me emër **I (7) – Ndryshime në provigjonet për dëme bruto – pjesë për risigurim** e paraqet dallimin ndërmjet provigjonit për dëme – pjesë për risigurim në fund dhe provigjonit për dëme – pjesë për risigurim në fillim të periudhës përlogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 406.

Pozita nr. 235 me emër **II – NDRYSHIME NË PROVIGJONET E TJERA TEKNIKE, NETO NGA RISIGURIMI** i përfshin ndryshimet në provigjonin matematike dhe ndryshimet neto në provigjonet



e tjera teknike. Paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitat nr. 236 dhe 239. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 41.

Pozita nr. 236 me emër **II (1) – Ndryshime në provigjonin matematik, neto nga risigurimi** paraqet dallim nga vlera e shprehur në pozitat nr. 238 dhe 239.

Pozita nr. 237 me emër **II (1.1.) – Ndryshime në provigjonin matematik bruto** i përfshin ndryshimet në provigjonin matematik bruto, gjegjësisht dallimi ndërmjet provigjonit matematik bruto në fund dhe provigjonit matematik bruto në fillim të periudhës përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 4100, 4102 dhe 4103.

Pozita nr. 238 me emër **II (1.2.) – Ndryshime në provigjonin matematik bruto – pjesë për bashkësigurim/risigurim** paraqet dallim ndërmjet provigjonit matematik bruto – pjesë për bashkësigurim/risigurim në fund dhe provigjonit matematik bruto – pjesë për bashkësigurim/risigurim në fillim të periudhës përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 4110, 4112 dhe 4113.

Pozita nr. 239 me emër **II (2) – Ndryshime në provigjonin e barazimit, neto nga risigurimi** përfshin ndryshime në provigjonin e barazimit ndërsa paraqet dallim nga vlera e shprehur në pozitat nr. 241 dhe 242.

Pozita nr. 240 me emër **II (2.1.) – Ndryshime në provigjonin e barazimit bruto** ka të bëjë me ndryshimet në provigjonin e barazimit bruto dhe paraqet dallim ndërmjet provigjonit të barazimit bruto në fund dhe provigjonit të barazimit bruto në fillim të periudhës përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 414.

Pozita nr. 241 me emër **II (2.2.) – Ndryshime në provigjonin e barazimit bruto – pjesë për bashkësigurim dhe risigurim** paraqet dallim ndërmjet provigjonit të barazimit bruto, pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në fund të periudhës dhe provigjonit të barazimit bruto, pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në fillim të periudhës. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 415.

Pozita nr. 242 me emër **II (3) – Ndryshime në provigjonet e tjera teknike, neto nga risigurimi** përfshin ndryshime në provigjonet e tjera teknike (të cilat përfshijnë provigjone të tjera teknike), ndërsa paraqet dallim nga vlera e shprehur në pozitat nr. 244 dhe 245.

Pozita nr. 243 me emër **II (3.1.) – Ndryshime në provigjonet e tjera teknike bruto** ka të bëjë me ndryshimet në provigjonet e tjera teknike bruto dhe paraqet dallim ndërmjet provigjoneve të tjera teknike bruto në fund dhe provigjonet e tjera teknike bruto në fillim të periudhës përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 412 dhe 416.

Pozita nr. 244 me emër **II (3.2.) – Ndryshimet në provigjonet e tjera teknike bruto – pjesë për bashkësigurim dhe risigurim** paraqet dallim ndërmjet provigjoneve të tjera teknike bruto, pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në fund të periudhës dhe provigjonet e tjera teknike bruto, pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në fillim të periudhës. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 413 dhe 417.

Pozita nr. 245 me emër **III – NDRYSHIME NË PROVIGJONIN MATEMATIK PËR SIGURIM JETE KU RREZIKU INVESTUES ËSHTË NË KURRIZ TË TË SIGURUARIT, NETO NGA RISIGURIMI** përfshin ndryshime në provigjonin matematik për sigurim jete ku rreziku investues është në kurriz të të siguarit, neto nga risigurimi ndërsa paraqet dallim nga vlera e shprehur në pozitat nr. 247 dhe 248.

Pozita nr. 246 me emër **III (1) – Ndryshime në provigjonin matematik bruto për sigurim jete ku rreziku investues është në kurriz të të siguarit** ka të bëjë me ndryshimet në provigjonin matematik bruto për sigurim jete ku rreziku investues është në kurriz të të siguarit në fund dhe

provigjoni matematik bruto për sigurim jete ku rreziku investues është në kurriz të të siguruarit në fillim të periudhës përlllogaritës. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 4101.

Pozita nr. 247 me emër **III (2) – Ndryshime në provigjonin matematik bruto për sigurim jete ku rreziku investues është në kurriz të të siguruarit – pjesë për bashkësigurim dhe risigurim** paraqet dallim ndërmjet provigjonit matematikë bruto për sigurim jete ku rreziku investues është në kurriz të të siguruarit – pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në fund të periudhës dhe provigjonit matematik bruto për sigurim jete ku rreziku investues është në ngarkesë të të siguruarit – pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në fillim të periudhës. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 4111.

Pozita nr. 248 me emër **IV – SHPENZIME PËR BONUZE DHE LIRIME, NETO NGA RISIGURIMI** paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitat nr. 250 dhe 251.

Pozita nr. 249 me emër **IV (1) – Shpenzime për bonuse (të cilat varen nga rezultati) –** paraqesin pjesë nga pozita nr. 249 e cila ka të bëjë me shpenzimet për kthim të primit të cilat varen nga rezultati. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 4200.

Pozita nr. 250 me emër **IV (2) – Shpenzime për lirime (të cilat nuk varen nga rezultati) –** paraqesin pjesë nga pozita nr. 249 e cila ka të bëjë me shpenzimet për kthim të primit të cilat nuk varen nga rezultati. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 4201.

Pozita nr. 251 me emër **V – NETO SHPENZIME PËR ZBATIMIN E SIGURIMIT –** paraqet shumë nga pozitat 252 dhe 256, gjegjësisht shumë nga shpenzimet për blerje të policave të sigurimit dhe shpenzimeve administrative të shoqërive të sigurimeve.

Pozita nr. 252 me emër **V (1) – Shpenzimet e blerjes të policave** paraqesin shumën e zërave nr. 253, 253a, 254 dhe 255. Ky pozicion tregon kostot që lidhen drejtpërdrejt me lidhjen e kontratave të reja të sigurimit ose rinovimin e kontratave ekzistuese të sigurimit.

Pozita nr. 253 me titullin **V (1.1.) - Komisioni** i referohet kostove të bëra nga shoqëritë e sigurimit si rezultat i komisioneve të llogaritura në bazë të kontratave të lidhura të sigurimit. Komisioni zakonisht shprehet si përqindje e vlerës së transaksionit, dhe rrallë si një shumë fikse. Ky pozicion tregon shumën e regjistruar në llogarinë 430.

Pozita nr. 253a me emërtimin **V (1.2.) - Paga bruto për punonjësit në rrjetin e brendshëm të shitjeve** i referohet kostove të pagave dhe kontributeve në pagat e punonjësve në rrjetin e brendshëm të shitjeve. Ky pozicion tregon shumën e regjistruar në llogarinë 4700.

Pozita nr. 254 me emër **V (1.3.) – Shpenzimet e tjera për blerje të policave** i referohen shpenzimet e tjera për blerje të policave të shoqërive të sigurimeve që njihen si të tilla sipas Rregullores për planin kontabël të shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve, me përjashtim të atyre të deklaruara në pozicionin nr. 253 dhe 253a. Në këtë pozicion është shënuar shuma e një pjese të shpenzimeve të raportuara në llogarinë 453.

Pozita nr. 255 me emër **V (1.4) – Ndryshim në shpenzimet e anuluarat për blerje të policave** ka të bëjë me anulimin kohor të shpenzimeve për blerje të policave të cilat mund të anulohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës për sigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 438.

Pozita nr. 256 me emër **V (2.) – Shpenzime administrative** paraqet shumë nga pozitat nr. 257, 258, 259 dhe 260 ndërsa ka të bëjë me shpenzimet e lidhura me pagesën e primit, menaxhimin me portofol, përpunim të bonuseve dhe lirimeve, risigurim aktiv dhe pasiv etj. Veçanërisht përmban shpenzime për të punësuarit, shpenzime për amortizim, shpenzime për shërbime të personave fizikë të cilët nuk kryejnë veprimtari dhe shpenzime të tjera administrative. Në këto shpenzime shprehen edhe shpenzimet për ripërtëritje të policave. Shpenzimet administrative nuk mund të përkufizohen.

Pozita nr. 257 me emër **V (2.1) – Amortizim të mjeteve materiale të cilat shërbejnë për kryerje të veprimtarisë** ka të bëjë me amortizimin e mjeteve ekzistuese materiale gjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit.. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 44.

Pozita nr. 258 me emër **V (2.2.) – Shpenzime për të punësuarit** paraqet shumë nga pozitat nr. 258a, 258b, 258c, 258ç dhe 258d dhe e njëjta ka të bëjë me shpenzimet për paga të të punësuarve, shpenzime për tatime dhe kontribute për paga, kontribute nga sigurimi i detyruar social, shpenzime për sigurim pensional shtesë të të punësuarve dhe shpenzime të tjera për të punësuarit.

Pozita nr. 258a me emër **V (2.2.1) – Paga dhe kompensime** ka të bëjë me pagat dhe kompensimet e të punësuarve. Në këtë pozitë shprehet pjesa nga shuma e evidentuar në kontot 4701 dhe 4702 e cila ka të bëjë me pagat dhe kompensimet e të punësuarve.

Pozita nr. 258b me emër **V (2.2.2) – Shpenzime për tatime për paga dhe kompensime të pagës** ka të bëjë me shpenzimet për tatime për paga dhe kompensime të pagës së të punësuarve. Në këtë pozitë shprehet pjesa nga shuma e evidentuar në kontot 4701 dhe 4702 e cila ka të bëjë me shpenzimet për tatime për paga dhe kompensime të pagës së të punësuarve.

Pozita nr. 258c me emër **V (2.2.3) – Kontribute nga sigurimi i detyruar social** ka të bëjë me shpenzimet për kontribute nga sigurimi i detyruar social i të punësuarve. Në këtë pozitë shprehet pjesa nga shuma e evidentuar e kontove 4701 dhe 4702 e cila ka të bëjë me shpenzimet për kontribute nga sigurimi i detyruar social i të punësuarve.

Pozita nr. 258ç me emër **V (2.2.4) – Shpenzime për sigurim pensional shtesë për të punësuarit** ka të bëjë me shpenzimet për sigurim pensional shtesë për të punësuarit. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 471.

Pozita nr. 258d me emër **V (2.2.5) – Shpenzime të tjera për të punësuarit** ka të bëjë me të gjitha shpenzimet e tjera për të punësuarit. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 479.

Pozita nr. 259 me emër **V (2.3.) – Shpenzime për shërbime të personave fizikë të cilët nuk kryejnë veprimtari (kontrata për punë, kontrata autoriale dhe raporte të tjera juridike) së bashku me të gjitha shpenzimet.** Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 431.

Pozita nr. 260 me emër **V (2.4.) – Shpenzime të tjera administrative** ka të bëjë me shpenzimet e tjera administrative të shoqërive të sigurimeve, duke përfshirë shpenzime për shërbimet, shpenzime materiale dhe shpenzime për rezervime. Kjo pozitë paraqet shumë nga pozitat 260a, 260b dhe 260c.

Pozita nr. 260a me emër **V (2.4.1) – Shpenzime për shërbime** ka të bëjë me shpenzimet për shërbime të shoqërive të sigurimeve. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 432, 433, 434, 435, 436, 4371d, 4372 dhe 439.

Pozita nr. 260b me emër **V (2.4.2) – Shpenzime materiale** ka të bëjë me shpenzimet materiale të shoqërive të sigurimeve. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 450, 451, 452, 453d, 454, 455, 456 dhe 459.

Pozita nr. 260c me emër **V (2.4.3) – Shpenzime për rezervim dhe shpenzime të tjera nga veprimtaria** ka të bëjë me shpenzimet për rezervim dhe shpenzimet e tjera nga veprimtaria e shoqërive për sigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 46.

Pozita nr. 261 me emër **VI – SHPENZIME NGA INVESTIMET** paraqet shumë nga pozitat nr. 262, 263, 264, 265, 266 dhe 270.

Pozita nr. 262 me emër **VI (1) – Amortizimi dhe përshtatshmëria e vlerës së mjeteve materiale të cilat nuk shërbjenë për kryeje të veprimtarisë** ka të bëjë me amortizimin e patundshmërive të cilat në mënyrë kontabiliste trajtohen sipas SNK 40 dhe të cilat vlerësohen sipas modelit të shpenzimeve. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 490.

Pozita nr. 263 me emër **VI (2) – Shpenzime për interes** paraqet shpenzim të shoqërive për sigurim, gjegjësisht risigurim në bazë të interesit nga investimet, gjegjësisht shpenzim i çmimit të përdorimit të mjeteve të parave. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 480.

Pozita nr. 264 me emër **VI (3) – Dallime negative të kursit** ka të bëjë me dallimet negative të kursit të cilat dalin nga ndryshimet e kursit të mesëm të valutave të huaja gjatë përlogaritjes së vlerës së investimeve të shoqërive të sigurimeve, gjegjësisht risigurim. Në mënyrë kontabiliste trajtohen në përputhje me SNK 21: Efektet nga ndryshimet në kurset e devizave. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 481.

Pozita nr. 265 me emër **VI (4) Përshtatshmëri e vlerës (humbje jo të realizuara, rënie në vlerë objektive)** ka të bëjë me humbjen të cilën shoqëria e sigurimeve e ka realizuar si rezultat të përshtatshmërisë së vlerës së pronës financiare të klasifikuar në portofolin e investimeve për tregti (sipas vlerës objektive). Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 483.

Pozita nr. 266 me emër **VI (5) – Humbje të realizuara nga shitja e pronës financiare – humbje kapitale** ka të bëjë me humbjet të cilat shoqëria e sigurimeve i realizon gjatë shitjes së pronës financiare. Kjo pozitë paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitat 267, 268 dhe 269.

Në pozitën nr. 267 me emër **VI (5.1) – Investime financiare të disponueshme për shitje** shprehet shuma e evidentuar në konton 4841.

Në pozitën nr. 268 me emër **VI (5.1) – Investime financiare për tregti** shprehet shuma e evidentuar në konton 4842.

Në pozitën nr. 269 me emër **VI (5.3) – Investime të tjera financiare** shprehet shuma e

evidentuar në konton 4840, 4843 dhe 4849.

Pozita nr. 270 me emër **VI (6) – Shpenzime të tjera nga investimet** i përfshin të gjitha shpenzimet e tjera të cilat shoqëria e sigurimeve i ka klasifikuar si shpenzim nga investimi. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 482, 485 dhe 489.

Pozita 271 me emër **VII – SHPENZIME TË TJERA TEKNIKE TË SIGURIMIT, TË ZVOGËLUARA PËR RISIGURIM** paraqesin shumë nga vlera e shprehur në pozitat nr. 282 dhe 283.

Pozita nr. 272 me emër **VII (1) – Shpenzime për preventivë** – Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 424.

Në pozitën nr. 273 me emër **VII (2) – Shpenzime të tjera teknike siguroese, të zvogëluara për risigurim** shprehet shuma e evidentuar në kontot 421, 422, 423, 425 dhe 429.

Pozita nr. 274 me emër **VIII – PËRSHTATSHMËRIA E VLERËS SË KËRKESAVE NË BAZË TË PRIMIT** ka të bëjë me korigjimin e vlerës së kërkesave në bazë të primit për sigurim në raport me rezervimin e kryer, lirimimin e rezervimit dhe kërkesa të paguara të shlyera më parë në bazë të primit për sigurim. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 494.

Pozita nr. 275 me emër **IX – SHPENZIME E TJERA DUKE PËRFSHIRË PËRSHTATSHMËRI TË VLERËS** ka të bëjë me shpenzimet e tjera të shoqërisë jo të shprehura në pozita të tjera. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot kolektive 491, 492, 493, 495, 496, 497 dhe 498.

Pozita nr. 276 me emër **X – FITIM PËR VITIN E PUNËS PARA TATIMIMIT** paraqet dallimin ndërmjet vlerës së shprehur në pozitën 200 dhe vlerës së shprehur në pozitën 226. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 801.

Pozita nr. 277 me emër **XI – HUMBJE PËR VITIN E PUNËS** paraqet dallimin ndërmjet vlerës së shprehur në pozitën 226 dhe vlerës së shprehur në pozitën 200. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 802.

Në pozitën nr. 278 me emër **XII – TATIM I FITIMIT, GJEGJËSISHT HUMBJE** shprehet shuma e evidentuar në konton 810 dhe 811.

Pozita nr. 279 me emër **XIII – TATIM I ANULUAR** paraqet tatimin e anuluar i cili është i përfshirë në përcaktimin e fitimit neto apo humbjes për periudhën.

Pozita nr. 280 me emër **XIV – FITIM PËR VITIN E PUNËS PAS TATIMIMIT** ka të bëjë me pjesën nga kapitali si rezultat i të ardhurave tepricë mbi shpenzimet e realizuara në periudhën aktuale përlllogaritëse pas përlllogaritjes së tatimit të fitimit. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 820.

Pozita nr. 281 me emër **XV – HUMBJE PËR VITIN E PUNËS PAS TATIMIT** ka të bëjë me pjesën nga kapitali si rezultat i shpenzimeve tepriçë mbi të ardhurat e realizuara në periudhën aktuale përlllogaritëse pas përlllogaritjes së tatimit të fitimit. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 821.

### 3. RAPORT PËR RRJEDHAT E PARAVE

#### 3.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Gjatë përpilimit të Raportit për rrjedhat e parave në kolonën 3 shënohen të dhënat për vitin aktual të punës ndërsa në kolonën 4 shënohen të dhënat për vitin e kaluar të punës. Për rrjedhat e parave në kuptim të kësaj rregullore llogaritet pagesa në para dhe ekuivalente të parave përmes xhiro-llogarive dhe llogarive devizore, duke përfshirë kompensime, asignacione dhe cesione të kryera përmes atyre llogarive në përputhje me SNK dhe standardet e tjera relevante.

Për rrjedha të parave nuk llogariten transferimet nga një llogari në tjetrën në kornizat e shoqërisë për sigurim.

Shuma e hyrjeve dhe daljeve të parave përcaktohet në bazë të evidencës për hyrjet dhe daljet e parave në arkë, në xhiro-llogaritë dhe llogaritë devizore të shoqërisë apo në bazë të gjendjes së qarkullimit të llogarive individuale të mjeteve dhe obligacioneve, gjegjësisht të ardhurat dhe shpenzimet, gjegjësisht grupe të kontove dhe konto në regjistrat afariste të shoqërisë.

#### 3.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIM të pozitave individuale në Raportin për rrjedhat e parave

##### A. RRJEDHAT E PARAVE NGA AKTIVITETET AFARISTE

Në pozitën nr. 300 me emër **A I – HYRJET E PARAVE NGA AKTIVITETET AFARISTE** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga kryerja e veprimtarive të sigurimit. Kjo pozitë paraqet shumë të vlerës së shprehur në pozitat nr. 301, 302, 303, 304 dhe 305.

Në pozitën nr. 301 me emër **A I (1) – Prim për sigurim dhe bashkësigurim dhe paradhënie të pranuar** shprehen gjithsej të hyrjet e parave nga kërkesat e paguara në bazë të primit për sigurim dhe primit për bashkësigurim nga të siguruarit gjegjësisht kontraktuesit e sigurimit gjatë periudhës përlllogaritëse dhe gjithsej hyrjet në bazë të paradhënieve të pranuar.

Në pozitën nr. 302 me emër **A I (2) – Prim për risigurim dhe retrocesion** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga kërkesat e paguara në bazë të primit për risigurim dhe retrocesion nga shoqëria e sigurimeve – ceduese gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 303 me emër **A I (3) – Hyrjet nga pjesëmarrja në kompensim të dëmeve** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga kërkesat e paguara në bazë të pjesëmarrjes në kompensim të dëmeve dhe kompensime për dëme në bazë të bashkësigurimit dhe risigurimit gjegjësisht retrocesionit gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 304 me emër **A I (4) – Interes i pranuar nga punët e sigurimit** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga kërkesat e paguara në bazë të interesit të dakorduar dhe paracaktuar nga të siguruarit, bashkësiguruarit, risiguruarit, retrocesionerët dhe debitorët regresorë, si dhe interes tjetër i paguar i cili del nga aktivitetet e punës së shoqërisë.

Në pozitën nr. 305 me emër **A I (5) – Hyrjet e tjera nga aktivitetet e punës** shprehen hyrjet e parave nga pagesa e kërkesave regresore, nga punët e ndërmjetësimit dhe përfaqësimit, nga aktivitetet shërbyese në bazë të llojit të hetimit, vlerësimit dhe likuidimit të dëmeve, nga pagesa e të ardhurave në bazë të qirave dhe huazimeve, anëtarësisë dhe të ardhurat tjera të punës së shoqërisë, si dhe pagesa e kërkesave nga të punësuarit dhe kërkesat e tjera.

Në pozitën nr. 306 me emër **A II – DALJET E PARAVE NGA AKTIVITETET AFARISTE** shprehen gjithsej daljet e parave nga punët e sigurimit. Kjo pozitë paraqet shumë të pozitave nr. 307, 308, 309, 310, 311, 312, 313 dhe 314.

Në pozitën nr. 307 me emër **A II (1) – Dëme të paguara, shuma të dakorduara të sigurimit, pjesëmarrje në kompensim të dëmeve nga bashkësigurimi dhe paradhëniet e dhëna** shprehen gjithsej pagesat e kryera të siguruave, shfrytëzuesve të sigurimit dhe personave të tretë të dëmtuar në emër kompensim të dëmeve dhe shuma të dakorduara të sigurimit në bazë të sigurimit dhe pjesëmarrjes në kompensim të dëmeve në bazë të bashkësigurimit gjatë periudhës përlllogaritëse dhe pagesat e kryera në bazë të paradhënieve të dhëna.

Në pozitën nr. 308 me emër **A II (2) – Dëme të paguara dhe pjesëmarrje në kompensim të dëmeve nga risigurimi dhe retrocesioni** shprehen gjithsej pagesat e kryera në bazë të pjesëmarrjes në kompensim të dëmeve dhe kompensime për dëme në bazë të risigurimit gjegjësisht retrocesionit gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 309 me emër **A II (3) – Prim për bashkësigurim, risigurim dhe retrocesion** shprehen gjithsej pagesat e kryera në bazë të primit për bashkësigurim dhe risigurim, gjegjësisht retrocesion gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 310 me emër **A II (4) – Kompensime dhe shpenzime të tjera personale** shprehen gjithsej pagesat e kryera në bazë të pagave të paguara bruto dhe përfitimet e tjera personale.

Në pozitën nr. 311 me emër **A II (5) – Shpenzime të tjera për zbatim të sigurimit** shprehen gjithsej pagesat e kryera në bazë të shpenzimeve për materiale, lëndë djegëse dhe energji të shpenzuar, huazime, reklamë dhe shpenzime të tjera për zbatim të sigurimit të kryera gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 312 me emër **A II (6) – Interes i paguar** shprehen gjithsej pagesat e kryera në bazë të interesit të paguara gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 313 me emër **A II (7) – Tatim i fitimit dhe shpenzime të tjera publike** shprehen gjithsej pagesat e kryera në bazë të akontacioneve të paguara për tatim dhe shpenzime të tjera publike pas përlllogaritjes përfundimtare për vitin e kaluar të zvogëluara për kthimin e kryer të mjeteve gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 314 me emër **A II (8) – Shpenzime të tjera të parave nga aktivitetet e punës** shprehen shpenzimet e parave që ndodhin jashtëzakonshëm, gjegjësisht të cilat nuk kanë karakter të hyrjeve të rregullta të parave nga aktivitetet e punës, si dhe daljet e parave për të cilat nuk janë të regjistruara detyrime.

Në pozitën nr. 315 me emër **A III – HYRJE E PARAVE NETO** shprehet dallimi ndërmjet vlerës së shprehur në pozitat me nr. 300 dhe 306.

Në pozitën nr. 316 me emër **A IV – HYRJET E PARAVE NETO** shprehet dallimin ndërmjet vlerës së shprehur në pozitat me nr. 306 dhe 300.

## **B. RRJEDHA TË PARAVE NGA INVESTIMET**

Në pozitën nr. 317 me emër **B I – HYRJET E PARAVE NGA INVESTIMET** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga aktivitetet e investimit. Kjo pozitë paraqet shumë të pozitave nr. 318, 319, 320, 321, 322, 323, 324 dhe 325.

Në pozitën nr. 318 me emër **B I (1) – Hyrjet nga shitja e mjeteve jo materiale** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga shitja e mjeteve jo materiale gjatë periudhës përlogaritëse.

Në pozitën nr. 319 me emër **B I (2) – Hyrjet e mjeteve nga shitja e mjeteve materiale** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga shitja e mjeteve materiale të cilat shërbejnë për kryerje të veprimtarisë së shoqërisë të sigurimeve gjatë periudhës përlogaritëse.

Në pozitën nr. 320 me emër **B I (3) – Hyrjet nga shitja e mjeteve materiale të cilat nuk shërbejnë për kryerje të veprimtarisë së shoqërisë** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga shitja e mjeteve materiale të cilat nuk shërbejnë për kryerje të veprimtarisë së shoqërisë për sigurim gjatë periudhës përlogaritëse.

Në pozitën nr. 321 me emër **B I (4) – Hyrjet e parave nga investimet në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara** shprehen gjithsej hyrjet e parave gjatë periudhës përlogaritëse në bazë të shitjes së plasmaneve afatshkurte dhe afatgjate financiare në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara të zvogëluara për pagesat e kryera të bëra me qëllim të arritjes së atyre plasmaneve.

Në pozitën nr. 322 me emër **B I (5) – Hyrjet e parave nga investimet të cilat ruhen deri në maturim** shprehen gjithsej hyrat e parave gjatë periudhës përlogaritëse në bazë të shitjes së investimeve financiare afatshkurte dhe afatgjate të cilat ruhen deri në maturim të zvogëluara për pagesat e kryera të bëra me qëllim të përvetësimit të atyre plasmaneve.

Në pozitën nr. 323 me emër **B I (6) – Hyrjet e parave nga plasmanet e tjera financiare** shprehen gjithsej hyrjet e parave gjatë periudhës përlogaritëse nga shitja e letrave me vlerë dhe pjesëmarrje të zvogëluara për pagesat e kryera të bëra me qëllim të arritjes së atyre plasmaneve.

Në pozitën nr. 324 me emër **B I (7) – Hyrjet e parave nga dividendat dhe pjesëmarrjet e tjera në fitim** shprehen gjithsej të hyrat e parave gjatë periudhës përlogaritëse në bazë të dividendës dhe pjesëmarrje të tjera në fitim.



Në pozitën nr. 325 me emër **B I (8) – Hyrje e parave nga interesi** shprehen gjithsej të hyrat e parave gjatë periudhës përlllogaritëse në bazë të interesit të paguar të cilat dalin nga investimet.

Në pozitën nr. 326 me emër **B II – DALJET E PARAVE NGA INVESTIMET** shprehen gjithsej daljet e parave nga aktivitetet e investimeve. Kjo pozitë paraqet shumë të pozitive nr. 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333 dhe 334.

Në pozitën nr. 327 me emër **B II (1) – Daljet e parave nga blerja e mjeteve jo materiale** shprehen gjithsej daljet e parave në bazë të arritjes (blerjes) së mjeteve jo materiale gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 328 me emër **B II (2) – Daljet e parave nga blerja e mjeteve materiale** shprehen gjithsej daljet e parave në bazë të arritjes (blerjes) së mjeteve materiale të cilat shërbejnë për kryerje të veprimtarisë së shoqërisë të sigurimeve gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 329 me emër **B II (3) – Daljet e parave nga blerja e mjeteve materiale të cilat nuk shërbejnë për kryerje të veprimtarisë** shprehen gjithsej daljet e parave në bazë të arritjes (blerjes) së mjeteve materiale të cilat nuk shërbejnë për kryerje të veprimtarisë së shoqërisë për sigurim gjatë periudhës përlllogaritëse.

Në pozitën nr. 330 me emër **B I (4) – Daljet e parave nga investimet në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara** shprehen gjithsej daljet e parave gjatë periudhës përlllogaritëse në bazë të arritjes (blerjes) së plasmaneve afatshkurte dhe afatgjate financiare në shoqëri në grup – filiale, shoqëri të bashkangjitura dhe entitete të përbashkëta të kontrolluara të zvogëluara për të daljet e parave në bazë të shitjes së atyre plasmaneve.

Në pozitën nr. 331 me emër **B II (5) – Daljet e parave nga investimet të cilat ruhen deri në maturim** shprehen gjithsej daljet e parave gjatë periudhës së përlllogaritur në bazë të arritjes (blerjes) së instrumenteve afatshkurte dhe afatgjate financiare (letra me vlerë) të cilat ruhen deri në maturim të zvogëluara për hyrjet e parave në bazë të shitjes së atyre letrave me vlerë.

Në pozitën nr.332 me emër **B II (6) – Daljet e parave nga plasmanet e tjera financiare** shprehen gjithsej të dalat e parave gjatë periudhës përlllogaritëse në bazë të blerjes së plasmaneve afatgjate dhe afatshkurte financiare të zvogëluara për gjithsej të hyrat e parave nga shitja apo realizimi i atyre plasmaneve (deponim dhe investim).

Në pozitën nr. 333 me emër **B II (7) – Daljet e parave nga dividendat dhe pjesëmarrjet e tjera në fitim** shprehen gjithsej daljet e parave gjatë periudhës përlllogaritëse në bazë të pagesës së dividendës dhe pjesëmarrjeve të tjera në fitim.

Në pozitën nr. 334 me emër **B II (8) – Daljet e parave nga interesi** shprehen gjithsej daljet e parave gjatë periudhës përlllogaritëse në bazë të interesit të paguar.

Në pozitën nr. 335 me emër **B III – HYRJET E PARAVE NETO** shprehet dallimi ndërmjet vlerës së shprehur në pozitë me nr. 317 dhe 326.

Në pozitën nr. 336 me emër **B IV – DALJET E PARAVE NETO** shprehet dallimi ndërmjet vlerës së shprehur në pozitë me nr. 326 dhe 317.

### C. RRJEDHAT E PARAVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE

Në pozitën nr. 337 me emër **C I – HYRJET E PARAVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE** shprehen gjithsej hyrjet e parave nga aktivitetet financiare. Kjo pozitë paraqet shumë të pozitave nr. 338, 339 dhe 340.

Në pozitën nr. 338 me emër **C I (1) – Hyrjet e parave në bazë të rritjeve të kapitalit aksionar** shprehen hyrjet e parave në bazë të pagesës së aksioneve në kapitalin aksionar të shoqërisë.

Në pozitën nr. 339 me emër **C I (2) –Hyrjet në bazë të kredive dhe huazimeve të aplikuara afatshkurte dhe afatgjate** shprehen hyrjet e parave në bazë të kredive dhe huazimeve afatshkurte dhe afatgjate, të zvogëluara për të gjitha pagesat e atyre kredive gjatë periudhës aktuale përlogaritëse.

Në pozitën nr. 340 me emër **C I (3) – Hyrjet e parave në bazë të obligimeve të tjera afatshkurte dhe afatgjate** shprehen hyrjet e parave në bazë të obligimeve të tjera afatshkurte dhe afatgjate, të zvogëluara për të gjitha pagesat e atyre obligimeve në periudhën aktuale përlogaritëse.

Në pozitën nr. 341 me emër **C II – DALJET E PARAVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE** shprehen gjithsej daljet e parave nga aktivitetet financiare. Kjo pozitë paraqet shumën e pozitave nr. 342,343 dhe 344.

Në pozitën nr. 342 me emër **B II (1) – Daljet në bazë të pagesës së kredive afatshkurte dhe afatgjate dhe huazime dhe obligime të tjera** shprehen daljet e parave në bazë të pagesës së kredive afatshkurte dhe afatgjate dhe huazime dhe obligime të tjera, të zvogëluara për shumën e huazimeve të reja, kredive dhe obligime në periudhën aktuale përlogaritëse.

Në pozitën nr. 343 me emër **B II (2) – Daljet në bazë të blerjes së aksioneve personale** shprehen daljet e parave në bazë të blerjes së aksioneve personale në periudhën aktuale përlogaritëse.

Në pozitën nr. 344 me emër **B II (3) – Daljet në bazë të pagesës së dividendës** shprehen daljet e parave në bazë të pagesës së dividendës në periudhën aktuale përlogaritëse.

Në pozitën nr. 345 me emër **C III – HYRJET E PARAVE NETO** shprehet dallimi ndërmjet vlerës së shprehur të pozitave me nr. 337 dhe 341.

Në pozitën nr. 346 me emër **C IV – DALJET E PARAVE NETO** shprehet dallimi ndërmjet vlerës së shprehur të pozitave me nr. 341 dhe 337.

## 4. RAPORTI PËR NDRYSHIME NË KAPITAL

### 4.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Raporti për ndryshime në kapital e paraqet rritjen gjegjësisht uljen e mjeteve neto të shoqërisë në periudhën ndërmjet dy periudhave të raportimit. Raporti për ndryshime në kapital përmban ndryshime të cilat dalin nga transaksionet me aksionar gjegjësisht ndryshime pronësore (emetim i aksioneve, blerje e aksioneve, pagesë e dividendës) dhe ndryshime të cilat dalin nga aktivitetet e shoqërisë (fitim, humbje).

### 4.2. UDHËZIM PËR PLOTËSIM të pozitave individuale në Raportin për ndryshime në kapital

#### 4.2.1. Përshkrim i pozitave të dhëna në kolona

Kolona me nr. rendor 1 – **Kapital aksionar** ka të bëjë me kapitalin aksionar të shoqërisë i cili duhet të paguhet në tërësi dhe në formë të parave ndërsa i cili nuk mund të jetë më i vogël se shuma e përcaktuar me ligj. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 90.

Kolona me nr. rendor 2 – **Prime të aksioneve të emetuara** ka të bëjë me pjesën nga kapitali i regjistruar i shoqërisë i cili paraqet shumë e cila paraqitet si rezultat i shitjes së aksioneve për çmim më të lartë sesa vlera e tyre nominale (provigjon kapital). Ka të bëjë me dallimin ndërmjet vlerës nominale dhe vlerës shitëse të aksioneve. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në kontot 910 dhe 911.

Kolona me nr. rendor 3 – **Provigjone ligjore** ka të bëjë me provigjonet e shoqërisë të cilat është e detyruar t'i ndajë nga fitimi i realizuar në përputhje me dispozitat nga Ligji për mbikëqyrje të sigurimit. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 9210.

Kolona me nr. rendor 4 – **Provigjone statutare** ka të bëjë me provigjonet të cilat shoqëria mund t'i ndajë dhe shfrytëzojë vetëm për qëllim të caktuar me Statutin e shoqërisë. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 9212.

Në kolonën me nr. rendor 5 – **Provigjone për aksione personale** shprehet shuma e evidentuar në konton 9211.

Në kolonën me nr. rendor 6 **Aksione të blera personale** shprehet shuma e evidentuar në konton 922.

Kolona me nr. rendor 7 – **Provigjone të tjera** ka të bëjë me provigjonet e tjera të cilat shoqëria i formon nga fitimi neto, në varësi nga nevojat e saj. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në konton 9213.

Kolona me nr. rendor 8 – **Provigjone** paraqet shumën nga vlera e shprehur në kolonat 3,4,5 dhe 7 e zvogëluar për vlerën e shprehur në kolonën 6.

Kolona me nr. rendor 9 – **Provigjone të rivlerësimit** paraqet korrigjim të kapitalit aksionar, gjegjësisht përshtatshmëri të kapitalit aksionar e cila kryhet në kushte të inflacionit me qëllim të mbrojtjes së mjeteve të pronarëve. Rivlerësimi paraqet përshtatshmëri të vlerës nominale të pozitave monetare dhe jo monetare të aktivës dhe kapitalit aksionar për shkak të ndryshimit të çmimit të produkteve. Rivlerësimi del nga përshtatshmëria e vlerës së normave individuale të mjeteve të shoqërisë për sigurim (patundshmëri, mjete financiare) në përputhje me trajtimin e tyre kontabilist, në pajtim me SNK 39 – Instrumente financiare: njohje dhe matje dhe SNK 16:

Patundshmëri, strehimore dhe pajisje. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 93.

Kolona me nr. rendor 10 – **Fitim jo i shpërndarë apo humbje e transferuar** paraqet shumë nga vlera e shprehur në pozitën fitim jo i shpërndarë neto, gjegjësisht pozita humbje e transferuar e cila formohet me vendim të Kuvendit të aksionarëve të shoqërisë për shpërndarje të fitimit si fitim jo i shpërndarë apo humbje e transferuar. Fitimi i mbajtur mund të shpërndahet më vonë, ndërsa humbja e transferuar të mbulohet. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 94.

Kolona me nr. rendor 11 – **Fitim apo humbje për periudhën aktuale përlllogaritëse** ka të bëjë me rezultatin financiar të shoqërisë i realizuar në periudhën e fundit përlllogaritëse. Në këtë pozitë shprehet shuma e evidentuar në grupin konto 95.

Kolona me nr. rendor 12 – **Gjithsej kapital dhe provigjone** ka të bëjë me gjithsej shumën e kapitalit aksionar, prime të aksioneve të emetuara, provigjone ligjore dhe statutare të shoqërisë, provigjon të rivlerësimit, fitim jo i shpërndarë apo humbje e transferuar dhe fitim apo humbje për periudhën aktuale përlllogaritëse.

#### 4.2.2. Përshkrim i pozitave të dhëna në rreshtat

Rreshti me nr. rendor I – **Gjendja e 1 janarit të vitit të kaluar të punës** ka të bëjë me gjendjen e kapitalit dhe provigjoneve më 1 janar të vitit të kaluar të punës.

Rreshti me nr. rendor I.1 – **Ndryshim në politikat kontabiliste** ka të bëjë me ndryshimet e gjendjes së kapitalit dhe provigjoneve si rezultat i aplikimit të SNK –a 8 Politikat kontabiliste, ndryshim në vlerësimet dhe gabimet kontabiliste, ndërsa i cili kërkon përshtatshmëri prapavepruese për efektet nga ndryshimi i politikave kontabiliste.

Rreshti me nr. rendor I.2 – **Korrigjimi i gabimeve në periudhën e kaluar** ka të bëjë me ndryshimet e gjendjes së kapitalit dhe provigjoneve si rezultat i aplikimit të SNK-a 8 Politikat kontabiliste, ndryshim në vlerësimet dhe gabimet kontabiliste, ndërsa i cili kërkon korrigjim prapaveprues të gabimeve.

Rreshti me nr. rendor II – **Gjendja e 1 janarit të vitit të kaluar të punës – e korrigjuar** ka të bëjë me gjendjen e kapitalit dhe provigjonet më 1 janar të vitit të kaluar të punës e korrigjuar si rezultat i ndryshimit në vlerësimet dhe gabimet kontabiliste, ndërsa i cili kërkon përshtatshmëri prapavepruese për efektet nga ndryshimi i politikave kontabiliste.

Rreshti me nr. rendor III – **Fitim apo humbje për vitin e kaluar të punës** ka të bëjë me zërat të ardhura dhe shpenzime, duke përfshirë përshtatshmëri për shkak të riklasifikimit, të cilat nuk njihen si fitim apo humbje siç nënshtrojnë dhe lejojnë SNRF të tjera dhe të cilat ndikojnë në ndryshimet në kapitalin gjatë periudhës të cilat kanë dalë nga transaksionet dhe ndodhi të tjera, përveç ndryshimeve të cilat dalin nga transaksionet me aksionarët. I përfshin pozitat në vijim:

Rreshti me nr. rendor. IV – **Ndryshime pronësore në kapital** ka të bëjë me transaksionet kapitale me aksionarët – pronarët, siç janë pagesat në kapital, blerje të aksioneve personale, dividenda dhe shpenzime transaksionale të cilat kanë të bëjnë me ato transaksione. Ka të bëjë me rritje, gjegjësisht ulje të kapitalit të shkruar, pagesat e tjera të aksionarëve, pagesat e dividendave dhe shpërndarje tjetër e pronarëve.

Rreshti me nr. rendor V – **Gjendje e 31.12 vitit të kaluar të punës** ka të bëjë me gjendjen e kapitalit dhe provigjonet e 31.12 të vitit të kaluar të punës.

Të dhënat me nr. rendor VI-X shoqëritë e sigurimeve i plotësojnë në mënyrë të njëjtë si pozita të përshkuara më parë vetëm me vlera të cilat kanë të bëjnë me vitin aktual të punës.

Tekst I konsoliduar jozyrtar

**ANEKSI 4 - SHQYRTIM I KONTOVE DHE GRUPEVE TË KONTOVE SIPAS POZITAVE NGA RAPORTET FINANCIARE**

**SHQYRTIM I KONTOVE DHE GRUPEVE TË KONTOVE NGA RAPORTI PËR GJENDJE FINANCIARE (BILANCI I GJENDJES)**

Numri i pozitës	Grup i kontove, konto
002	000
003	001, 002, 003, 004, 009
007	010, 013d 014d 015d 016d
008	011, 013d 014d 015d 016d,
010	020, 023d 024d 025d
011	021, 023d 024d 025d
012	022, 023d 024d 025d, 029
014	03002, 03012, 03022, 03032
015	03000, 03001, 03003, 03010, 03011, 03013, 03020, 03021, 03023, 03030, 03031, 03033
016	03102, 03112, 03122, 03132
017	03100, 03101, 03103, 03110, 03111, 03113, 03120, 03121, 03123, 03130, 03131, 03133
018	03004, 03009, 03014, 03019, 03024, 03029, 03034, 03039
019	03104, 03109, 03114, 03119, 03124, 03129, 03134, 03139
020	032
023	040000, 040010, 040100, 040110, 040200, 040210, 040290, 041000, 041010, 041100, 041110, 041200, 041210, 041290, 042000, 042010, 042100, 042110, 042200, 042210, 042290, 043000, 043010, 043100, 043110, 043200, 043210, 043290
024	040001, 040011, 040101, 040111, 040201, 040211, 040291, 041001, 041011, 041101, 041111, 041201, 041211, 041291, 042001, 042011, 042101, 042111, 042201, 042211, 042291, 043001, 043011, 043101, 043111, 043201, 043211, 043291
026	050000, 050010, 050100, 050110, 050200, 050210, 050290, 051000, 051010, 051100, 051110, 051200, 051210, 051290, 052000, 052010, 052100, 052110, 052200, 052210, 052290, 053000, 053010, 053100, 053110, 053200, 053210, 053290
027	050001, 050011, 050101, 050111, 050201, 050211, 050291, 051001, 051011,

Tekst I konsoliduar jozyrtar

	051101, 051111, 051201, 051211, 051291, 052001, 052011, 052101, 052111, 052201, 052211, 052291, 053001, 053011, 053101, 053111, 053201, 053211, 053291
028	050002, 050012, 050212, 050292, 051002, 051012, 051202, 051212, 051292, 052002, 052012, 052212, 052292, 053002, 053012, 053202, 053212, 053292
029	05022, 05122, 05222, 05322
031	060000, 060010, 060100, 060110, 060200, 060210, 060290, 061000, 061010, 061100, 061110, 061200, 061210, 061290, 062000, 062010, 062100, 062110, 062200, 062210, 062290, 063000, 063010, 063100, 063110, 063200, 063210, 063290
032	060001, 060011, 060101, 060111, 060201, 060211, 060291, 061001, 061011, 061101, 061111, 061201, 061211, 061291, 062001, 062011, 062101, 062111, 062201, 062211, 062291, 063001, 063011, 063101, 063111, 063201, 063211, 063291
033	060002, 060012, 060212, 060292, 061002, 061012, 061202, 061212, 061292, 062002, 062012, 062212, 062292, 063002, 063012, 063202, 063212, 063292
036	080
037	0810
038	0811
039	083, 089
040	07
041	133
043	6001
044	6011
045	6031, 6041
046	6051
047	6061
048	6071
049	6021
050	09
052	198
053	170
056	120, 121, 129д
057	122, 129д
058	128, 129д
060	130, 131, 132, 139д
061	140, 141, 142, 149д
062	138, 139д, 148, 149д
064	15
065	16
066	171, 172, 173, 174, 175, 178д, 179
067	178д
070	012, 013д 014д 015д, 016д
071	013д, 014д 015д, 016д 019
073	100, 102, 104
074	103, 105
075	101
076	106, 109, 110, 111, 112, 119
077	30, 31, 32

Tekst I konsoliduar jozyrtar

079	190
080	192
081	191,193,199
082	082
084	990, 991, 992, 993 и 994
087	900
088	901
089	902
090	91
092	931
093	932
094	930, 939
096	9210
097	9212
098	9211
099	922
100	9213
101	940
102	941
103	950
104	951
105	247
107	6000
108	6010
109	6030, 6040
110	6050
111	6060
112	6070
113	6020
115	250, 251, 252, 259д
116	253, 254, 255, 259д
118	295
119	280
120	212
123	200, 201
124	202
125	209
127	210, 211
128	220, 221, 222
129	219, 229
131	23
132	24
133	27, 281,282,283,284,285,286,289д
134	290, 291, 292, 293, 294, 296
135	289д
136	
137	995, 996, 997, 998 и 999

Tekst I konsoliduar jozyrtar

**SHQYRTIM I KONTOVE DHE GRUPEVE TË KONTOVE SIPAS POZITAVE NGA RAPORTI PËR FITIM  
GJITHPËRFSHIRËS (BILANCI I SUKSESIT)**

Numri i pozitës	Grup i kontove, konto
2	3
202	700
203	701
204	702
205	703
206	704
207	705
208	706
209	707
211	7200, 7210, 7220, 7230, 7240, 7250, 7260, 7270, 729д
213	7279
214	7245
215	7263
216	7201, 7202, 7203, 7204, 7205, 7206, 7209
217	7221, 7222, 7223, 7224, 7225, 7226, 7229
218	7251, 7252, 7253, 7259
220	7261
221	7262
222	7269
223	7211, 7231, 7232, 7239, 7241, 7242, 7243, 7244, 7249, 729д
223a	710
224	711, 712, 713, 714, 719
225	730, 731, 732, 733, 734, 735, 736, 737, 738, 739
228	400
229	401
230	402
231	403
232	404
233	405
234	406
237	4100, 4102, 4103
238	4110, 4112, 4113
240	414
241	415
243	412, 416
244	413, 417
246	4101
247	4111
249	4200
250	4201
253	430
253a	4700
254	4370, 4371d, 453d
255	438
257	44
258a	4701d, 4702d,
258б	4701d, 4702d,
258в	4701d, 4702d,
258г	471



Tekst I konsoliduar jozyrtar

258д	479
259	431
260а	432, 433,434, 435, 436, 4371д, 4372, 439,
260б	450,451,452,453д, 454,455,456,459,
260в	460, 461, 462, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469
262	490
263	480
264	481
265	483
267	4841
268	4842
269	4840, 4843, 4849
270	482,485,489
272	424
273	421, 422, 423, 425, 429
274	494
275	491, 492, 493, 495, 496, 497, 498
276	801
277	802
278	810, 811
280	820
281	821